



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

Ekstra 75

10 Gusht

2011

## Vendime të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut

Vendim i GJEDNJ datë 8.3.2011	Çështja Delvina kundër, Shqipërisë ankimi nr.49106/06 .....	3
Vendim i GJEDNJ	Vendim mbi pranueshmërinë nga Vefa Holding sh.p.k. dhe Alimuçaj kundër Shqipërisë, ankim nr.24096/05.....	12
Vendim i GJEDNJ datë 15.3.2011	Çështja Çausht Driza kundër Shqipërisë, ankimi nr.10810/05)	24
Vendim i GJEDNJ datë 7.12.2010	Çështja Vrioni dhe të tjerët kundër Shqipërisë, ankimi nr.35720/04 dhe 42832/06.....	33
Udhëzim nr.17 datë 5.11.2010	Për përcaktimin e numrit të profileve e mostrave për sipërfaqen e tokës që analizohet dhe vlerës së analizave të tokës.....	38
	Vendim ( <i>i shkurtuar</i> ) për heqjen e zotësisë për të vepruar shtetasen Lumturi Bami dhe vendosjen kujdestare kërkuesen Anila Bami.....	38
	Vendim ( <i>i shkurtuar</i> ) për heqjen e zotësisë për të vepruar shtetasit Xhaferr Nuzi dhe caktimin si kujdestare kërkuesen Kristina Nuzi.....	38
	Vendim ( <i>i shkurtuar</i> ) për heqjen e zotësisë për të vepruar dhe vendosjen e kujdestarisë për shtetasen Lindita Alushi .....	39

Vendim ( <i>i shkurtuar</i> ) për heqjen e zotësisë për të vepruar dhe vendosjen e kujdestarisë për shtetasen Shpresa Balliu .....	39
Vendim ( <i>i shkurtuar</i> ) për heqjen e zotësisë për të vepruar shtetasit Albert Caca dhe caktimin si kujdestare kërkuesen Servete Murati .....	39
Vendim ( <i>i shkurtuar</i> ) për heqjen e zotësisë për të vepruar shtetases Anisa Tabaku dhe caktimin si kujdestare kërkuesen Liliana Tabaku.....	39
Vendim ( <i>i shkurtuar</i> ) për heqjen e zotësisë për të vepruar shtetases Sanije Qoshja dhe caktimin si kujdestar kërkuesin Ismet Qoshja.....	39
Vendim ( <i>i shkurtuar</i> ) për heqjen e zotësisë për të vepruar shtetases Denisa Çeço dhe caktimin si kujdestare kërkuesen Geralda Çeço.....	39
Vendim ( <i>i shkurtuar</i> ) për heqjen e zotësisë për të vepruar dhe vendosjen e kujdestarisë për shtetasin Mentor Vathi .....	39
Vendim ( <i>i shkurtuar</i> ) për heqjen e zotësisë për të vepruar shtetasit Mustafa Cela dhe caktimin si kujdestare kërkuesen Liljana Cela .....	39
Vendim ( <i>i shkurtuar</i> ) për heqjen e zotësisë për të vepruar shtetasit Myrteza Dema dhe caktimin si kujdestare kërkuesen File Dema .....	39
Vendim ( <i>i shkurtuar</i> ) për heqjen e zotësisë për të vepruar për shtetasen Flutura Kasem Bami dhe caktimin si kujdestare ligjore kërkuesen Miranda Qemal Bami.....	39
Vendim ( <i>i shkurtuar</i> ) për heqjen e zotësisë për të vepruar shtetases Flutura Farruku dhe caktimin si kujdestare kërkuesen Drita Farruku .....	39
Vendim ( <i>i shkurtuar</i> ) për heqjen e zotësisë për të vepruar shtetases Lumturi Kurti dhe caktimin si kujdestare të kërkueses Shqipe Kurti.....	39
Vendim ( <i>i shkurtuar</i> ) për heqjen e zotësisë juridike për të vepruar shtetasit Bledar Metalla dhe caktimin si kujdestare kërkuesen Luljeta Metalla .....	39

SEKSIONI I KATËRT  
ÇËSHTJA DELVINA KUNDËR SHQIPËRISË  
(ANKIMI NR.49106/06)

**VENDIM**  
(THEMELI)  
STRASBURG  
8 MARS 2011

Ky vendim do të marrë formë të prerë në rrethanat e përcaktuara në nenin 44§2 të Konventës. Ai mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.

Në çështjen Delvina kundër Shqipërisë,  
Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), në cilësinë e një Dhome të përbërë nga:

Nikolas Bratza, kryetar,  
Ljiljana Mijović  
Sverre Erik Jebens  
Päivi Hirvelä  
Ledi Bianku  
Vincent A. de Gaetano, gjykatës  
dhe Lawrence Early, regjistruar i seksionit  
Pas shqyrtimit me dyer të mbyllura më 15 shkurt 2011  
Shpall vendimin e mëposhtëm, të miratuar po në atë datë.

**PROCEDURA**

1. Çështja e ka zanafillën në ankimin (nr.49106/06) kundër Republikës së Shqipërisë e depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (Konventa) nga tre shtetas Shqiptarë, z.Sherif Delvina, z.Ahmet Delvina dhe znj.Fatime Delvina (ankuesit), më 23 nëntor 2006.

2. Ankuesit u përfaqësuan nga znj. L.Suli, avokate që ushtron profesionin e saj në Tiranë. Qeveria Shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga agjentja e saj në atë kohë, znj.S.Meneri.

3. Ankuesit pretendonin shkelje të nenit 6§1 të Konventës në lidhje me parregullsinë e procedurave vendase dhe moszbatimin e vendimit përfundimtar të gjykatës. Gjithashtu, ato u bazuan në nenin 13 të Konventës dhe nenin 1 të protokollit nr.1 të Konventës në lidhje me mungesën e mjetit efektiv ligjor për sa i përket shumës së kompensimit të tyre.

4. Më 14 shkurt 2008 kryetari i seksionit, të cilit i ishte caktuar çështja, vendosi ta njoftojë Qeverinë për ankimin. Sipas dispozitave të nenit 29 § 3 të Konventës, u vendos që themeli i çështjes të shqyrtohej në të njëjtën kohë me pranueshmërinë e tij.

5. Secila nga palët, ankuesit dhe Qeveria, depozituan vëzhgimet e tyre të mëtejshme me shkrim (rregulli 59§1).

**FAKTET**

**RRETHANAT E ÇËSHTJES**

6. Ankuesit kanë lindur përkatësisht më: 1932, 1934 dhe 1942, dhe jetojnë në Shqipëri.

A. Historiku i çështjes dhe procedurat administrative

7. Më 1950-ën një parcelë toke me sipërfaqe 1,600 m<sup>2</sup>, e cila i përkiste babait të ankuesve u konfiskua nga regjimi pa u kompensuar, i cili më pas ndërtoi një ndërtesë në parcelën e tokës.

8. Më 1 korrik 1991 Ambasada Italiane në Shqipëri bleu dy ndërtesa në Tiranë, njëra prej të cilave ndodhej në parcelën e tokës së trashëguar të ankuesve. Transaksioni u përfundua nëpërmjet një marrëveshjeje ndërshtetërore, e vërtetuar me shkëmbime të notave verbale mes dy qeverive. Të drejtat përkatëse të pronësisë nuk u regjistruan në zyrën e Regjistrimit të Pasurive në Tiranë.

9. Si rrjedhojë, Qeveria Shqiptare përdori të ardhurat nga transaksioni për të blerë ambientet e Ambasadës Shqiptare në Romë (*shih, gjithashtu, Vrioni dhe të tjerë kundër Shqipërisë dhe Italisë, nr.35720/04 dhe 42832/06, §§ 7-16, 29 shtator 2009 për një përshkrim të ngjashëm të fakteve*).

10. Sipas ligjit të kthimit dhe kompensimit të pronave, ankuesit ngritën padi pranë Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, "Komisioni" në Tiranë, duke pretenduar të drejtën mbi pronën e babait të tyre.

11. Më 28 korrik 1999, Komisioni u njohu ankuesve të drejtën mbi pronën e babait të tyre për sipërfaqen prej 1,600 m<sup>2</sup> dhe pranoi faktin se parcela e tokës ishte zënë nga Ambasada Italiane në Shqipëri. Meqenëse ndërtesat ishin ndërtuar në atë tokë, Komisioni vendosi që zotëruesi i tyre, Qeveria Italiane, duhej të paguante qira për tokën ose të riblinte tokën me marrëveshje.

12. Gjithashtu, ankuesit u pajisën me një certifikatë regjistrimi pasurie lëshuar nga zyra e regjistrimit të pasurive: regjistrimi nr.137, datë 9 gusht 1999.

13. Ankuesit pretendonin se ato i dërguan letra Ambasadës Italiane që të paguante një tarifë qiraje ose t'ia shisnin parcelën e tokës sipas vendimit të Komisionit. Megjithatë, Ambasada Italiane shpjegoi se prona u kishte kaluar atyre nëpërmjet shkëmbimit të notave verbale më 1991-in.

A. Proceset gjyqësore lidhur me kthimin e pronave dhe kompensimin

14. Më 16 janar 2003 ankuesit ngritën padi për të rimarrë pronën dhe për të përfutur dëmet nga autoritetet italiane.

15. Më 22 qershor 2004 Gjykata e Rrethit Tiranë anuloi vendimin e Komisionit në lidhje me kthimin fizik të pronës ankuesve, meqenëse kjo parcelë toke ishte zënë në mënyrë të ligjshme nga Ambasada Italiane që më 1991. Për më tepër, ajo vendosi që ankuesit të kompensoheshin për sipërfaqen prej 1,600 m<sup>2</sup> në një nga mënyrat e parashikuara me ligj. Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë, nëpërmjet vendimeve të arsyetuara, miratuan vendimin e Gjykatës së Rrethit respektivisht më 25 mars 2005 dhe 6 qershor 2006. Më 24 nëntor 2006 ankuesit ngritën padi kushtetuese pranë Gjykatës Kushtetuese.

16. Më 8 dhjetor 2006, Gjykata Kushtetuese, me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, e shpalli ankimin të papranueshëm.

## I. E DREJTA E BRENDSHME PËRKATËSE

### A. Kushtetuta

17. Dispozitat përkatëse të Kushtetutës shqiptare citojnë si më poshtë:

#### Neni 42 § 2

"Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj."

#### Neni 142 § 3

"Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore."

#### Neni 131

"Gjykata Kushtetuese vendos për:... f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave."

### B. Ligji i pronave

18. E drejta e brendshme vendase në lidhje me kthimin dhe kompensimin e pronave në Shqipëri është përshkruar në vendimet e Gjonbocari dhe të tjerë kundër Shqipërisë, nr.10508/02, §§ 36-43, 23 tetor 2007, Driza kundër Shqipërisë, nr.33771/02, §§ 36-43, 13 nëntor 2007, Ramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë, nr.38222/02, §§ 23-30 13 nëntor 2007.

19. Masa të reja dhe thelbësore legislative janë miratuar duke ndryshuar ligjin e pronave të vitit 2004 që me miratimin e këtyre vendimeve. Ndryshimet kryesore janë si më poshtë vijon:

1. Ligji i pronave 2005 (ligji nr.9388 i datës 4 maj 2005)

20. Seksioni 3 zgjati deri më 31 dhjetor 2007 afatin për përfundimin e shqyrtimit të ankimeve për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pasurisë së paluajtshme, me përjashtim të pagesës së shumës së kompensimit, afati i së cilës u caktua për vitin 2015.

2. Ligji i pronave 2006 (ligji nr.9583 i datës 17 korrik 2006)

21. Seksioni 13 krijoi Agjencinë për Kthimin dhe Kompensimin e pronave (agjencia qendrore) e cila zëvendësoi Komitetin Shtetëror mbi Kthimin dhe Kompensimin e Pronave (Komitetin Shtetëror). Agjencia qendrore, e cila drejtohej nga një drejtor, e kishte qendrën në Tiranë dhe përbëhej nga dymbëdhjetë zyra rajonale të agjencisë.

22. Sipas seksionit 14, zyra rajonale e Agjencisë ishte përgjegjëse për shqyrtimin fillestar të ankimeve për njohjen e të drejtave të pronës, në përgjigje të së cilës ajo vendosi kthimin e pronës dhe/ose kompensimin *in lieu*/në vend të saj. Seksioni 15 përcaktoi afatin për parashtrimin e ankimeve për njohjen e të drejtave të pronës për 1 tetor 2007.

23. Seksioni 16 përcaktoi se kundër vendimit të zyrës së agjencisë rajonale mund të apelohej pranë Agjencisë qendrore. Kundër vendimit të Agjencisë qendrore mund të apelohej pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë brenda 30 ditëve nga njoftimi i tij.

24. Seksioni 21 zgjati deri më 31 qershor 2008 afatin për përfundimin e shqyrtimit të ankimeve për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pasurisë së paluajtshme, me përjashtim të pagesës së kompensimit.

25. Seksioni 22 parashikoi krijimin e Fondit të Kompensimit në Natyrë (FKNN), së bashku me Fondin e Kompensimit Financiar (FKF). Qeveria duhej të miratonte listën e pronave që do t'i alokoheshin FKNN-së, brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit.

3. Ligji i pronave 2007 (ligji nr.9684 i datës 6 shkurt 2007)

26. Seksioni 1 parashikonte se Agjencia qendrore ishte përgjegjëse për shqyrtimin e kërkesave për kompensimet në natyrë dhe në para. Agjencia qendrore ishte, gjithashtu, përgjegjëse për shqyrtimin e ankesave kundër vendimeve të zyrave rajonale të Agjencisë.

27. Seksioni 2 rikujtonte se zyrat rajonale të Agjencisë vazhdonin të ishin përgjegjëse për shqyrtimin fillestar të ankimeve për njohjen e të drejtave të pronës. Ankuesi ose Zyra e Avokatit të Shtetit kishte të drejtë të apelonte kundër këtij vendimi brenda 30 ditëve pranë Agjencisë qendrore, e cila ishte organi më i lartë administrativ. Një vendim i tillë administrativ ishte i përshtatshëm për shqyrtim gjyqësor në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

4. Ligji i pronave 2008 (ligji nr.9898 i datës 10 prill 2008)

28. Seksioni 1 zgjati deri më 31 dhjetor 2008 afatin për paraqitjen e ankimeve për njohjen e të drejtave të pronës dhe kthimin e pronave nga zyrat rajonale të Agjencisë. Gjithashtu, ai parashikonte mundësinë që ankuesit t'i jepej një afat i ri nëpërmjet një vendimi gjykate.

29. Sipas seksionit 2, përfundimi i shqyrtimit të ankimeve për njohjen e të drejtave të pronës dhe kthimin e pronave do të mbaronte më 30 qershor 2009, me përjashtim të pagesës së shumës së kompensimit, afati i së cilës u caktua për vitin 2015.

30. Seksioni 3 zgjati deri më 31 dhjetor 2008 afatin për alokimin e pronave FKNN-së.

5. Ligji i pronave 2009 (ligji nr.10 095 i datës 12 mars 2009)

31. Seksioni 2 parashikonte që përveç ndarjeve buxhetore, alokimeve të përfuara nëpërmjet këtij ligji dhe donatorëve të tjerë, FKF-ja do të përbëhej, gjithashtu, nga fitimet e përfuara nëpërmjet ankandëve të pronave shtetërore, të cilat nuk i ishin nënshtruar vendimit të Komisionit.

6. Ligji i pronave 2009 (ligji nr.10 207 i datës 23 dhjetor 2009)

32. Seksioni 6 shfuqizoi zyrat rajonale të agjencisë. Sipas këtij seksioni, arkivat e këtyre zyrave do t'i kalonin Agjencisë qendrore. Sipas seksionit 1, Agjencia qendrore do të përfundonte shqyrtimin e ankimeve për njohjen e të drejtave të pronës dhe kthimin e pronave parashtruar pranë zyrave të mëparshme rajonale të Agjencisë. Agjencia qendrore do të vazhdonte të shqyrtonte ankimet e bëra pranë saj kundër vendimeve të zyrave të mëparshme rajonale të Agjencisë.

33. Sipas nenit 5, ankuesi ose Zyra e Avokatit të Shtetit kishte të drejtë të apelonte kundër vendimit të Agjencisë qendrore brenda 30 ditëve nga njoftimi i tij pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë.

34. Seksioni 7 përcaktoi afatin për përfundimin e shqyrtimit të ankimeve për njohjen dhe kthimin e pronave për 31 dhjetor 2011.

7. Ligji i pronave 2010 (ligji nr.10 308 i datës 22 korrik 2010)

35. Ligji i pronave 2010 paraqiste kryesisht mundësinë e kërkesës për rishikimin e vendimeve të komisioneve të mëparshme/zyrave rajonale të Agjencisë.

36. Seksioni 4 zgjati deri më 31 dhjetor 2011 afatin për alokimin e pronave FKNN-së.

C. Vendimet e Këshillit të Ministrave

1. Vendimet e Këshillit të Ministrave (VKM) mbi dhëniet nga Fondi i Kompensimit Financiar

(vendimin e Këshillit të Ministrave nr.13 i datës 17 nëntor 2005; vendimin e Këshillit të Ministrave nr.758 i datës 16 nëntor 2006; vendimin e Këshillit të Ministrave nr.566 i datës 5 shtator 2007; vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1343 i datës 4 qershor 2008; dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr.487 i datës 6 maj 2009).

37. Sipas nenit 23 të ligjit të pronave 2004, i cili krijoi fondin e kompensimit financiar, Qeveria miratoi vendimet e lartpërmendura, në lidhje me dhënien e kompensimit financiar ish-pronarëve.

38. Në vitin 2005 kompensimi financiar është dhënë në lidhje me pretendimet për kompensim që dalin nga vendimet e Komisionit të Tiranës. Në vitin 2006 kompensimi financiar është dhënë në lidhje me pretendimet për kompensim që dalin nga vendimet e komisioneve të Tiranës dhe Kavajës. Në vitin 2007 grupi i përfituesve u zgjerua duke përfshirë ish-pronarë të cilët përfitonin nga një vendim i Komisionit i nxjerrë në lidhje me qytetet për të cilët ishte miratuar dhe nxjerrë një hartë e vlerësimit të pronave. Në vitin 2008 dhe 2009, të gjithë ish-pronarët, të cilëve u ishte njohur e drejta e kompensimit, sipas vendimit të komisionit/agjencisë rajonale, ishin të pranueshëm për të aplikuar për kompensim financiar.

39. Sipas VKM-ve të miratuara ndërmjet viteve 2005 dhe 2008, ankuesit i kërkohej të bënte një kërkesë standard për kompensim financiar pranë agjencisë qendrore në Tiranë, duke paraqitur, *inter alia*, vendimin e komisionit/agjencisë rajonale, i cili e njihte të drejtën e tij për kompensim. Vetëm ish-pronarët, të cilët nuk kishin marrë kompensim të mëparshëm, u njihej e drejta për kompensim financiar nga viti 2005 deri në vitin 2008. Vendimi i Këshillit të Ministrave i vitit 2009 parashikonte që një ish-pronari i njihej e drejta për kompensim financiar, me kusht që ai nuk kishte përfituar nga: a) kompensimi i mëparshëm; b) kthimi i pjesshëm i pronës; c) e drejta e refuzimit të parë; d) zbatimi i ligjit mbi shpërndarjen e tokës (ligji nr.7501 i datës 19 korrik 1991).

40. Kërkesat do të shqyrtoheshin në renditje kronologjike mbi bazën e datës dhe numrit të vendimit të Komisionit/agjencisë rajonale. Shuma e kompensimit financiar, e cila duhej të llogaritej mbi bazën e hartave të vlerësimit të pronave, kufizohej deri në një maksimum prej 200 m<sup>2</sup>.

41. Parashtrimi i kërkesës sillte pagesën e tarifës së procesit. Ish-pronarët, të cilët nuk kanë pasur sukses me kërkesat e tyre për kompensim financiar në vitin e mëparshëm, mund të riparashtronin kërkesën e tyre në vitin (vitet) në vazhdim pasi të kenë paguar tarifën e procesit.

42. Asnjë nga këto vendime nuk parashikonte dhënien e kompensimit pretenduesve që dalin nga një vendim përfundimtar dhe i zbatueshëm gjykatë.

2. Vendimin e Këshillit të Ministrave mbi hartat e vlerësimit të pronave (vendimi i Këshillit të Ministrave nr.555 i datës 29 shtator 2007; vendimi i Këshillit të Ministrave nr.653 i datës 29 gusht 2007; vendimi i Këshillit të Ministrave nr.139 i datës 13 shkurt 2008; dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr.1620 i datës 26 nëntor 2008).

43. Bazuar në vendimet e lartpërmendura, dy nga të cilat u miratuan në vitin 2007 dhe dy në vitin 2008, Qeveria miratoi dhe nxori harta të vlerësimit të pronave siç renditen më lart. Hartat përfshinin çmimin e referencës për metër katror në të gjithë vendin.

44. Vendimi i parë caktoi çmimin e tokës për rajonet Berat, Gjirokastrë, Vlorë dhe Dibër; Vendimi i dytë caktoi çmimin e tokës për rajonet Lezhë, Dibër, Korçë dhe Kukës; Vendimi i tretë caktoi çmimin e tokës për rajonet Fier, Elbasan, Tiranë, Vlorë, Durrës dhe Shkodër. Vendimi i katërt përmbante një listë të përditësuar të çmimeve për qytete të caktuara. Sipas këtij vendimi, çmimi i referencës për metër katror, për zonat në të cilat ndodhej prona e aplikuesit është vlerësuar për të gjithë 180,000.

3. Vendimi i Këshillit të Ministrave mbi kompensimet në natyrë të ish-pronarëve (vendimi i Këshillit të Ministrave nr.567 i datës 5 shtator 2007)

45. Ligji i pronave 2006 parashikonte krijimin e Fondit të Kompensimit në Natyrë (FKNN). Qeveria duhej të miratonte procedurat për shpërndarjen e pronave të mbuluara nga FKNN.

46. Me vendim të datës 5 shtator 2007, Qeveria përcaktoi kriteret dhe procedurat për përcaktimin e pronave shtetërore të mbuluara nga FKNN (vendimi i Këshillit të Ministrave nr.567 i datës 5 shtator 2007). Seksioni 1 rendit llojet e pronave, për shembull: a) pronë publike e paluajtshme, e cila ndodhet në zona turistike; b) pronat e Ministrisë së Mbrojtjes, të cilat nuk janë përdorur nga Forcat e Armatosura dhe janë miratuar nga Presidenti i Republikës; c) tokat bujqësore në dispozicion që i përkasin Ministrisë së Bujqësisë; d) pyjet, kullotat dhe livadhet; dhe e) pronat e institucioneve shtetërore, të cilat janë jashtë aktivitetit të tyre të ardhshëm.

47. Agjencia dhe zyrat e saj rajonale janë përgjegjëse për kontrollin e statusit ligjor të çdo prone të paraqitur nga institucioni shtetëror përkatës. Agjencia paraqet listën përfundimtare të pronave të paluajtshme për t'i përfshirë në FKNN-në e Ministrisë së Drejtësisë. Qeveria miraton listën dhe e publikon atë në Fletoren Zyrtare.

48. Deri më sot, duket se një listë e tillë akoma nuk është miratuar.

## E DREJTA

### I. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

49. Ankuesit ankuan se procesi gjyqësor ishte i parregullt. Ato, gjithashtu, pretenduan se zbatimimi i vendimit të Gjykatës së Apelit i datës 25 mars 2005 ka tejkaluar afatin e arsyeshëm kohor.

Neni 6 § 1 i Konventës, në lidhje me sa më sipër, citon si më poshtë vijon:

“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë...., e cila do të vendosë qoftë për mosmarrëveshjet mbi të drejtat dhe detyrimet e tij me karakter civil.....”.

#### A. Parregullsia e procesit gjyqësor

50. Ankuesit pretenduan se gjykatat vendase kanë vlerësuar në mënyrë të gabuar provat dhe kanë keqinterpretuar të drejtën vendase. Qeveria argumentoi se procedurat vendase kanë qenë të rregullta. Sipas pikëpamjes së saj, argumentet e ankuesve janë trajtuar në mënyrë të saktë nga gjykatat vendase.

51. Në lidhje me ankimin e ankuesve për vlerësimin e provave dhe interpretimin e së drejtës vendase, Gjykata rikujton se nuk është brenda sferës së saj të zëvendësojë vlerësimin e saj të fakteve me atë të gjykatave vendase dhe, si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave të vlerësojnë provat përpara tyre dhe të interpretojnë të drejtën vendase. Detyra e Gjykatës është të sigurojë nëse procedurat në tërësinë e tyre, duke përfshirë mënyrën në të cilën janë marrë provat, kanë qenë të rregullta (*shih Jakupi kundër Shqipërisë (dhjetor), nr.11186/03, 1 dhjetor 2009; Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë nr.7352/03, § 37, 22 gusht 2006*).

52. Gjykata vlerëson se nuk është provuar se procedurat përpara gjykatave vendase nuk ishin në përputhje me kërkesat e nenit 6 § 1 të Konventës. Ankuesit u përfaqësuan ligjërisht. Ato kishin mundësinë të parashtronin argumentet e tyre dhe të mbronin pikëpamjet e tyre. Gjykatat vendase, pas vlerësimit të të gjitha provave, dhanë vendime të arsyeshme dhe rrëzuan pretendimin e tyre. Gjykata nuk është në gjendje të dallojë asnjë shenjë arbitrariteti në vendimet e gjykatave vendase. Ajo nuk konstaton ndonjë shenjë të shkeljes së nenit 6 § 1 të Konventës sipas këtij kreu.

53. Rezulton se ky ankim është haptazi i pabazuar dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës.

#### B. Moszbatimi i vendimit të Gjykatës së Lartë i datës 6 qershor 2006

##### 1. Pranueshmëria

54. Gjykata vlerëson se ky ankim nuk është haptazi i pabazuar sipas kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Më tej, ajo vlerëson se çështja nuk është e papranueshme nga çdo pikëpamje tjetër. Prandaj, për këtë arsye duhet të deklarohet si e pranueshme.

##### 2. Meritat

55. Ankuesit parashtruan se autoritetet nuk kanë marrë asnjë masë për zbatimin e vendimit të Gjykatës së Apelit të datës 25 mars 2005.

56. Qeveria argumentoi se ankuesit asnjëherë nuk kanë kërkuar kompensim pranë autoriteteve vendase. Sipas pikëpamjes së Qeverisë, autoritetet nuk kanë qenë të detyruara të bëjnë ofertë, duke pasur parasysh se ankuesit kanë kundërshtuar vlerësimet e gjykatave vendase.

57. Në lidhje me fushën e këtij ankimi, Gjykata vëren në fillim se neni 6 mbron zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe të detyrueshme, dhe jo vendime të cilat mund të bëhen objekt i kontroleve të mëtejshme të një gjykate të shkallës më të lartë dhe, përfundimisht, e anuloi atë (*shih, për shembull, Ouzounis dhe të tjerë kundër Greqisë, nr.49144/99, § 21, 18 prill 2002; Ioannis Karaholios kundër Greqisë (dhjetor), nr.62499/00, 26 shtator 2002; Xheraj kundër Shqipërisë, nr.37959/02, § 70, 29 korrik 2008*). Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se ky ankim duhet të shërbejë për zbulimin e moszbatimit të vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 6 qershor 2006, i cili përfundimisht njohu të drejtën e ankuesve për kompensim *in lieu* të kthimit të pronës, edhe pse Gjykata e Apelit, për zhgënjimin e ankuesve, arriti të njëjtin konkluzion më 25 mars 2005.

58. Parimet e përgjithshme sipas nenit 6 § 1 të Konventës, për sa i përket moszbatimit të vendimeve përfundimtare të gjykatës përcaktohen në Gjyli kundër Shqipërisë, nr.32907/07, §§ 43-44, 29 shtator 2009 dhe Beshiri dhe të tjerë, cituan më lart, §§ 60-61.

59. Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës së Lartë urdhëroi kompensimin e ankuesve në lidhje me parcelën e tokës së tyre me sipërfaqe 1,600 m<sup>2</sup>. Deri më sot, autoritetet nuk kanë marrë asnjë masë për të zbatuar këtë vendim në favor të ankuesve.

60. Më tej Gjykata, rikujton se një personi, i cili ka fituar një vendim të zbatueshëm kundër Shtetit si rezultat i çështjes së suksesshme gjyqësore, nuk mund t'i kërkohej të përdorë procedurat e zbatimit me qëllim që vendimi të ekzekutohet (*shih Beshiri dhe të tjerë, cituar më lart, § 54*).

61. Për më tepër, Gjykata ka konstatuar shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për shkak të moszbatimit të vendimit përfundimtar të gjykatës, e cila ka caktuar kompensim *in lieu* të kthimit të pronave në rastet e Beshiri dhe të tjerë (*cituar më lart §§ 62-66*); *Driza (cituar më lart §§ 87-94)*; dhe *Vrioni dhe të tjerë kundër Shqipërisë dhe Italisë (nr.35720/04 dhe 42832/06, §§ 54-61, 29 shtator 2009)*. Ajo nuk sheh arsye që të largohet nga këto vlerësime në rastin konkret.

62. Si rrjedhim, Gjykata konkludon se ka pasur shkelje të së drejtës së ankuesve për akses në gjykatë sipas nenit 6 § 1 të Konventës.

#### C. Kohëzgjatja e procedurave

63. Gjykata vlerëson se ankimi sipas këtij kreu nuk është haptazi i pabazuar në kuptim të nenit 35 § 3 të Konventës. Për më tepër ajo vlerëson se nuk është përcaktuar asnjë bazë tjetër për të deklaruar këtë pjesë të ankimit të papranueshëm dhe prandaj e deklaroi atë të pranueshëm.

64. Megjithatë, Gjykata vlerëson më tej se në dritën e vlerësimeve të saj për shkelje sipas nenit 6 § 1 të Konventës, në lidhje me moszbatimin e vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 6 qershor 2006, ajo nuk duhet të vendosë më vete mbi meritat e kohëzgjatjes së procedurave të ankimit (*shih Vrioni dhe të tjerë kundër Italisë dhe Shqipërisë, cituar më lart, § 66*; *Lizanets kundër Ukrainës, nr.6725725/03, § 48, 31 maj 2007*).

## II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 13 NË LIDHJE ME NENIN 6 § 1 TË KONVENTËS

65. Sipas nenit 13 të Konventës, ankuesit argumentuan se ata nuk kishin asnjë mjet efektiv ligjor për të zbatuar vendimin e formës së prerë në favor të tyre.

Neni 13 i Konventës citon si më poshtë:

“Çdo person, të cilit i kanë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë, ka të drejtë të paraqesë një ankim efektiv përpara një instance kombëtare, edhe kur kjo shkelje është kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare.”

#### A. Pranueshmëria

66. 54. Gjykata vlerëson se ky ankim nuk është haptazi i pabazuar sipas kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Më tej, ajo vlerëson se çështja nuk është e papranueshme nga çdo pikëpamje tjetër. Prandaj, për këtë arsye duhet të deklarohet si e pranueshme.

#### B. Meritat

67. Gjykata rithekson se në vendimin e saj, në çështjen e lartpërmendur *Driza*, ajo vlerësoi si më poshtë:

“118. Gjykata vëren se ligji i pronave 1993 (i cili është shfuqizuar nga ligji i pronave 2004, i cili më tej është amenduar nga ligji i pronave 2006) parashikonte forma të ndryshme të kompensimit në rastet kur prona origjinale nuk mund t'i kthehej ish-pronarit (...). Ligji i pronave 1993 i la vendosjen e formës së duhur të kompensimit Këshillit të Ministrave, i cili duhej të përcaktonte rregullat e hollësishme dhe metodat e zbatueshme për dispozitat e kompensimit. Sipas vlerësimeve të Gjykatës së Lartë në vendimin e saj të datës 7 dhjetor 2000, organet kompetente për t'u marrë më çështje të kompensimit akoma nuk ishin ngritur (...). Me gjithë hyrjen në fuqi të ligjit të pronave 2004 situata nuk ndryshoi. Vetëm më 28 prill 2005, Parlamenti miratoi një ligj, i cili përcaktonte metodologjinë për vlerësimin e pronës për qëllime kompensimi. Seksioni 5 i këtij ligji i la detyrë për zbatimin e kësaj metodologjie Komitetit Shtetëror mbi Kthimin dhe Kompensimin e Pronave, i cili duhej të nxirrte plane të përshtatshme truall për të lejuar vlerësimin e pronave. Megjithatë deri më sot, këto plane nuk janë miratuar.

119. Si rrjedhojë, Gjykata vlerëson se në mungesë të organeve të duhura për t'u marrë me çështje të kompensimit ose miratimin e planeve të truallit për vlerësimin e pronave, Qeveria dështoi të përcaktonte një procedurë të duhur në lidhje me pretendimet për kompensim. Për më tepër, nuk ka gjasa



që Qeveria të vendosë një sistem të tillë në mënyrë të shpejtë apo brenda një hapësire kohore të mjaftueshme për të mundësuar zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në lidhje me përcaktimin e të drejtave të ankuesve.”.

68. Në rastin në fjalë, Gjykata vëren se që në datën e miratimit të vendimit të çështjes “Driza”, Qeveria ka mundësuar dispozita të reja ligjore në lidhje me dhënien e kompensimit financiar, miratimin e hartave të vlerësimit të pronave dhe krijimin e FKNN-së (*shih seksionin më lart “E drejta vendase përkatëse”*). Prandaj Gjykata duhet të përcaktojë nëse masat e marra përbëjnë një mjet ligjor efektiv në kuptim të nenit 13 të Konventës.

69. Gjykata rikujton se neni 13 i Konventës i jep shprehje të drejtpërdrejtë detyrimit të Shteteve, parashikuar në nenin 1 të Konventës, për të mbrojtur pikësëpari dhe kryesisht të drejtat e njeriut brenda sistemit të tyre ligjor. Prandaj ajo kërkon që shtetet të sigurojnë një mjet ligjor vendas për t’u marrë me thelbin e “ankimit të argumentueshëm” sipas Konventës dhe për të ofruar ndihmën e përshtatshme (Burdov kundër Ruisë (nr.2), nr.33509/04, § 96, GJEDNJ 2009-....; dhe Yuriy Nikolayevich Ivanov kundër Ukrainës, nr.40450/04, § 63, GJEDNJ 2009-.... (ekstrakte)).

70. Sipas nenit 13 të Konventës, hapësira e detyrimeve të shteteve kontraktuese ndryshon në varësi të natyrës së ankimit të ankuesve; “efektiviteti” i një “mjeti ligjor” në kuptim të kësaj dispozite nuk varet nga siguria e një rezultati të favorshëm për ankuesin. Në të njëjtën kohë mjeti ligjor i kërkuar sipas nenit 13 duhet të jetë “efektiv” si në praktikë, ashtu edhe në ligj në kuptimin që ose të pengojë shkeljen e pretenduar apo vazhdimin e saj, ose të sigurojë zgjidhjen e duhur për çdo shkelje që ka ndodhur (*shih Burdov (nr.2), cituar më lart, § 97, dhe Yuriy Nikolayevich Ivanov, cituar më lart, § 63*).

71. Në rastin konkret Gjykata vëren që në fillim se vendimi i Qeverisë mbi dhënien e kompensimit financiar përcakton në mënyrë të saktë se pretenduesi mund të përlligjë të drejtën e tij për kompensim bazuar në vendimin e Komisionit. Dispozitat mbi kompensimin financiar nuk zbatohen për pretenduesit, si për ankuesit në rastin konkret, të cilët pretendojnë kompensim të zbatueshëm bazuar në një vendim përfundimtar gjykate.

72. Duke pasur parasysh informacionin në posedim të saj, Gjykata vëren më tej se, në praktikë, Agjencia i ka caktuar kompensim vetëm pretenduesve të cilët posedojnë një vendim Komisioni. Pretenduesve të cilët posedojnë një vendim përfundimtar dhe të zbatueshëm gjykate, nuk u është dhënë kompensim.

73. Për më tepër, Gjykata nuk mund të përcaktojë masa të tjera të cilat janë aprovuar me qëllim që të sigurohet zbatimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës që i cakton kompensim një ankuesi *in lieu* të kthimit të pronës. Qeveria nuk ka parashtruar asnjë provë për të kundërtën.

74. Sa më lart, Gjykata vlerëson se ankuesit nuk kishin mjet ligjor efektiv që t’i mundësonte ato të siguronin zbatimin e së drejtës së tyre për kompensim të njohur me vendim përfundimtar gjykate.

75. Si rrjedhim, ka pasur shkelje të nenit 13 në lidhje me nenin 6 § 1 të Konventës.

### III. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR.1 TË KONVENTËS

76. Ankuesit pretenduan se dështimi për t’i paguar atyre kompensim sipas vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 6 qershor 2006 shkakton shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1, i cili parashikon:

“Çdo person fizik dhe juridik ka të drejtën që t’i respektohet pasuria e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushte të parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligjet që ato i quajnë të domosdoshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagesën e taksave, ose të kontributeve të tjera ose të gjobave.”

#### A. Pranueshmëria

77. Gjykata çmon se ankimi sipas këtij kreu nuk është haptazi i pabazuar në kuptim të nenit 35 § 3 të Konventës. Për më tepër ajo vlerëson se nuk është përcaktuar asnjë bazë tjetër për të deklaruar këtë pjesë të ankimit të papranueshëm dhe prandaj e deklaroi atë të pranueshëm.

#### B. Meritat

78. Qeveria parashtrroi se nuk kishte lidhje shkakore ndërmjet këtij ankimi dhe detyrimit të autoriteteve për të siguruar kompensim.

79. Gjykata rikujton se “pretendim” mund të përbëjë “pasuri” në kuptim të nenit 1 të protokollit nr.1 nëse është përcaktuar në mënyrë të mjaftueshme për të qenë i zbatueshëm (*shih Stran Greek Refineries dhe Stratis Andreadis kundër Greqisë, vendim i datës 9 dhjetor 1994, seria A nr.301-B, f. 84, § 59*).

80. Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 6 qershor 2006 u siguroi ankuesve pretendimin e zbatueshëm për kompensim *in lieu* të kthimit të pronës.

81. Gjykata rikujton praktikën e saj gjyqësore se pamundësia e ankuesit për të fituar ekzekutimin e vendimit përfundimtar të gjykatës në favor të tij ose të saj përbën ndërhyrje në të drejtën për gëzimin paqësor të pasurisë, përcaktuar në fjalinë e parë të paragrafit të parë të nenit 1 të protokollit nr.1 (*shih ndërmjet autoriteteve të tjera, Burdov kundër Ruisë, nr.59498/00, § 40, GJEDNJ 2002-III*).

82. Gjykata vëren se ajo ka zbuluar, gjithashtu, shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për arsye të dështimit të autoriteteve për të zbatuar vendimin përfundimtar të gjykatës që cakton kompensimin (*shih paragrafët 58-62 më lart*).

83. Më tej, Gjykata vëren se ajo ka konstatuar, gjithashtu, shkelje të të drejtave të pronës së ankuesve për arsye të dështimit të autoriteteve për të siguruar kompensimin që rrjedh nga vendimi përfundimtar i gjykatës në rastet e Beshiri dhe të tjerë, cituar më lart, §§ 95-103; Driza, cituar më lart, §§ 101-109; dhe Vrioni dhe të tjerë kundër Shqipërisë dhe Italisë, nr.35720/04 dhe 42832/06, §§ 71-77, 29 shtator 2009. Gjykata nuk shikon arsye për të arritur në një konkluzion të ndryshëm në rrethanat e çështjes në fjalë.

84. Për rrjedhojë, ka pasur shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës.

#### IV. ZBATIMI I NENEVE 46 DHE 41 TË KONVENTËS

##### A. Neni 46 i Konventës

85. Gjykata vëren se në rastin në fjalë, ajo ka identifikuar mangësi në kuadrin rregullator shqiptar, për sa i përket mungesës së mekanizmit për të siguruar zbatimin e vendimit të formës së prerë të gjykatës që jep kompensim *in lieu* të kthimit të pronës. Mangësi të tilla duhet të trajtohen si një çështje urgjente duke pasur parasysh numrin e personave në situatën e ankuesve dhe hapësirën për ankime të tjera pranë Gjykatës duke ngritur të njëjtat çështje (*shih Driza cituar më lart, § 122*).

86. Në rast se shteti i paditur mbetet i lirë për të zgjedhur mjetet me anë të të cilave do të plotësojë detyrimet ligjore sipas nenit 46 të Konventës, me kusht që mjete të tilla të jenë në përputhje me konkluzionet e përcaktuara në vendimin e Gjykatës (*shih Burdov kundër Ruisë (nr.2) cituar më lart, § 136*), Gjykata vlerëson se masat e përgjithshme në nivel kombëtar janë të nevojshme për ekzekutimin e vendimit në fjalë.

87. Gjykata vëren se problemet e konstatuara në këtë rast në thelb të shkeljeve të nenit 6, nenit 13 në lidhje me nenin 6 dhe nenin 1 të protokollit nr.1, janë komplekse dhe strukturore. Ato kërkojnë miratimin dhe zbatimin e masave me karakter legjislativ dhe administrativ, duke përfshirë autoritete të ndryshme. Gjykata vlerëson se shteti i paditur duhet të marrë masa të mjaftueshme legjislative, administrative dhe financiare me qëllim që të sigurojë dhënien e kompensimit, pa vonesa të panevojshme, urdhëruar me vendim përfundimtar gjykate *in lieu* të kthimit të pronës. Për shembull, shteti i paditur duhet të përcaktojë një organ kompetent zbatues, të sigurojë burime të mjaftueshme njerëzore dhe materiale, të përcaktojë rregulla të qarta dhe të thjeshta të procedurave për mbledhjen e pretendimeve, të përcaktojë afate kohore reale dhe të detyrueshme për procedimin dhe zbatimin e tyre, të caktojë fondet e nevojshme buxhetore dhe të heqë të gjitha pengesat me qëllim që të sigurojë dhënien e kompensimit financiar ose në natyrë, duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

88. Gjykata rithekson se është me rëndësi vendimtare që një vendim gjykate kundër shtetit, pasi ka marrë fuqinë e *res judicata*, duhet të zbatohet pa vonesa të panevojshme. Ankuesit nuk duhet t'i kërkohej të mbajë barrën për ekzekutimin e vendimeve *res judicata* dhënë në favor të tij kundër shtetit (*shih mutati mutandis, Metaxas kundër Greqisë nr.8415/02, § 49, 27 maj 2004*). Dështimi i shtetit për të zbatuar vendimet *res judicata* cenon sigurinë publike në sistemin gjyqësor dhe respektin për shtetin e së drejtës, i cili është një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike dhe element i trashëguar në të gjithë nenet e Konventës (*shih mutatis mutandis, Stere dhe të tjerë kundër Rumanisë nr.25632/02, § 53, 23 shkurt 2006*).

**B. Neni 41 i Konventës**

**89. Neni 41 i Konventës parashikon:**

“Kur Gjykata konstaton shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj, dhe nëse e drejta e brendshme e palës së lartë kontraktuese mundëson vetëm ndreqje të pjesshme të pasojave që kanë rrjedhur nga kjo shkelje, Gjykata, nëse është e nevojshme, i jep palës së dëmtuar një shpërblim të drejtë.”

90. Ankuesit pretenduan 3,210,240 euro në lidhje me dëmin material, i cili përbënte 2,640,000 euro, për sa i përket vlerës së tokës dhe 570,240 euro në lidhje me humbjen e përfitimeve për një periudhë prej 10 vjetësh.

Ato u bazuan në një raport vlerësimi të pronës nga një ekspert për të përcaktuar vlerën e përgjithshme të tokës dhe humbjen e përfitimeve, në përputhje me të cilat çmimi i tregut të pronës ishte 1,650 euro për m<sup>2</sup> dhe çmimi i tregut për qiranë ishte 5,280 euro në muaj. Së fundi, ankuesit pretenduan 100,000 euro në lidhje me dëmin jomaterial.

91. Qeveria nuk parashitroi asnjë vëzhgim në këtë drejtim.

92. Gjykata vlerëson se çështja e zbatimit të nenit 41 nuk është gati për vendim. Si rezultat, çështja duhet të rezervohet dhe duhet të fiksohet një procedurë e mëtejshme duke i kushtuar rëndësi mundësisë së arritjes së një marrëveshjeje ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe ankuesve.

**PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NJEZËRI:**

1. Deklaron ankimin e ankuesve në lidhje me parregullsinë e procesit gjyqësor të papranueshëm dhe pjesën tjetër të ankimit të pranueshëm.

2. Vendos se ka shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për arsye të moszbatimit të vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 6 qershor 2006.

3. Vendos se nuk është e nevojshme të shqyrtohet ankimi i ankuesve sipas nenit 6 § 1 në lidhje me kohëzgjatjen e moszbatimit të vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 6 qershor 2006.

4. Vendos se ka shkelje të nenit 13 në lidhje me nenin 6 §1 të Konventës.

5. Vendos se ka shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës.

6. Vendos se çështja e ankimit të nenit 41 nuk është gati për vendim.

Si rezultat:

a) e rezervon tërësisht çështjen e sipërpërmendur.

b) fton Qeverinë dhe ankuesit të parashitrojnë, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi bëhet përfundimtar, në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, vëzhgimet e tyre të shkruara për çështjen dhe, në veçanti, të njoftojnë Gjykatën në rast të ndonjë marrëveshjeje që ato mund të arrijnë.

c) rezervon procedurën e mëtejshme dhe i delegon Kryetarit të Dhomës kompetencën e fiksimit të kësaj çështjeje nëse është e nevojshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim në datën 8 mars 2011, në përputhje me nenin 77 §§ 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

**SEKRETAR**  
**Lawrence Early**

**PRESIDENT**  
**Nikolas Bratza**

SEKSIONI I KATËRT  
VENDIM MBI PRANUESHMËRINË

ANKIMI NR.24096/05  
NGA VEFA HOLDING SHPK DHE ALIMUÇAJ  
KUNDËR SHQIPËRISË

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), në cilësinë e një dhome të përbërë nga:

Nicolas Bratza, kryetar,  
Lech Garlicki  
Ljiljana Mijović  
Ján Šikuta  
Päivi Hirvelä  
Zdravka Kalaydjieva  
Nebojša Vučinić, gjyqtarë  
and Fatoş Araci, zëvendësregjistruer i seksionit,  
*Duke pasur parasysht ankimin e mësipërm depozituar më 2 qershor 2005,*  
*Duke pasur parasysht vëzhgimet e parashtruara nga Qeveria e paditur dhe vëzhgimet,*  
*në përgjigje të parashtruara nga ankuesit,*  
Pas shqyrtimit, vendosi si më poshtë:  
FAKTET

1. Shoqëria ankuese, “Vefa Holding sh.p.k.”, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, aktualisht në administrim të kufizuar, me zyrë të regjistruar në Tiranë, Shqipëri. Ankimi është paraqitur në emër të saj nga z.Vehbi Alimuçaj, një shtetas shqiptar, i cili ka lindur në vitin 1949 dhe vuan dënimin me burgim në burgun e Peqinit (ankuesi individual). z.Alimuçaj ishte presidenti i shoqërisë ankuese dhe aksionari i vetëm i saj deri kur ajo u vendos në administrim të detyruar.

2. Ankuesit u përfaqësuan para Gjykatës nga z. Sh. Dizdari, avokat i cili ushtron profesionin në Tiranë. Qeveria Shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga agjentja e saj, znj. E. Hajro nga Avokatura e Shtetit.

A. Rrethanat e çështjes

3. Faktet e çështjes, siç u parashtruan nga palët, mund të përmbliidhen si më poshtë vijon.

4. Ankuesi individual ishte pronari i shoqërisë ankuese, e cila fillimisht u krijua si një shoqëri tregtare më 28 gusht 1992. Objekti i aktivitetit të saj u zgjerua në mënyrë progresive me kalimin e viteve, si rezultat i së cilës ajo ndryshoi emrin e saj të regjistruar dhe objektin e aktivitetit respektivisht më 14 dhjetor 1993, 10 dhjetor 1994 dhe 3 shkurt 1997, duke u njohur dhe regjistruar përfundimisht si “Vefa Holding sh.p.k.”. Për shkak të pavullnetshmërisë së bankave tregtare për të siguruar burime financiare për zgjerimin e saj, shoqëria ankuese hyri në kontrata huaje me individë. Dukej se nga viti 1994 deri në vitin 1997 shoqëria ankuese vazhdoi të merrte para hua me qëllim që të vazhdonte me planet e saj të investimit.

5. Në vitin 1997 Shqipëria u godit nga një trazirë civile në shkallë të gjerë, e cila u nxit nga rënia e të ashtuquajturave skema piramidale të cilat ishin krijuar gjatë viteve të mëparshme.

B. Procedurat e administrimit të detyruar

6. Shteti ndërhyri për të rivendosur rendin publik dhe miratoi legjislacionin.

7. Më 23 janar 1997 hyri në fuqi ligji i ndalimit të skemave piramidale (shih më poshtë “E drejta dhe praktika përkatëse vendase”). Ligji nuk lejoi që dy ankuesit të vazhdonin të hynin në kontratë huaje me individë për të ndjekur investimet e shoqërisë.

8. Më 9 maj 1997 hyri në fuqi ligji për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë (ligji nr.1). Ligji nr.1 pësoi një sërë ndryshimesh siç paraqiten në nenin më poshtë “E drejta dhe praktika përkatëse vendase”.

9. Më 22 gusht 1997 Qeveria vendosi që shoqëria ankuese t’i nënshtrohej një kontrolli financiar sipas nenit 5 të ligjit për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë (ligji nr.2). Prandaj ajo caktoi tre administratorë shqiptarë. Vendimi nuk përmendi asnjë argument të veçantë ligjor referuar në nenin 5, në të cilin u bazua Qeveria.

10. Në një datë të pacaktuar në vitin 1997 shoqëria ankuese apeloi kundër vendimit të Qeverisë të datës 22 gusht 1997 në Gjykatën e Apelit Tiranë (Gjykata e Apelit).

11. Më 17 shtator 1997, Gjykata e Apelit prishi vendimin dhe urdhëroi pezullimin e masës së administrimit të detyruar. Ajo konstatoi se nuk ekzistonte asnjë interes publik për caktimin e administratorëve.

12. Më 28 tetor 1997, Qeveria konfirmoi tre administratorët e njëjtë që kishte caktuar në vendimin e saj të mëparshëm të datës 22 gusht 1997, duke mos dhënë arsye të mëtejshme sipas nenit 5 të ligjit nr.2.

13. Më 6 nëntor 1997, Qeveria lidhi kontratë për shërbimet me një shoqëri ndërkombëtare, "D", e cila duhej të zëvendësonte tre administratorët individualë dhe të vepronte si një administrator i vetëm i shoqërisë ankuese. Sipas termave të përcaktuara, detyrat e D-së duhej të kryheshin në dy faza. Gjatë fazës së parë, *inter alia*, D-ja duhej të merrte kontrollin e shoqërisë ankuese, të ushtronte të gjitha kompetencat dhe të drejtat e caktuara në shoqëri, duke përfshirë kompetencën për të vazhduar biznesin e saj, për të paguar borxhet, për të ndërprerë aktivitetet, për të shitur asetet dhe për të mbajtur, pezulluar apo zëvendësuar stafin ose menaxherët. Do të përpilohej një inventar për asetet e shoqërisë ankuese dhe do të përgatitej një plan veprimi për rimëkëmbjen e aseteve. Do të kryhej një kontroll nga ekspertë kontabël cilësorë të cilët do të caktoheshin nga Qeveria. Gjatë fazës së dytë, D-ja do të zbatonte planin e veprimit për rimëkëmbjen e aseteve duke përfshirë shitjen e tyre, do të depozitonte të gjitha fitimet e rimëkëmbjes së aseteve pranë subjektit të caktuar nga Qeveria, do të asistonte në procesin e rishpërndarjes, do të bashkëpunonte në përgatitjen e një kontrolli financiar për situatën e mbylljes dhe do të përgatiste një raport përfundimtar për Qeverinë.

14. Në një datë të pacaktuar në vitin 1997, ankuesi individual kundërshtoi nenin 7 të ligjit nr.2 para Gjykatës Kushtetuese, meqenëse autorizonte administratorët ta zëvendësonin atë dhe të merrnin përsipër të gjitha të drejtat e pronës të cilat ishin *stricto sensu* të lidhura me pronësinë e tij të shoqërisë ankuese.

15. Më 13 nëntor 1997, Gjykata Kushtetuese shpalli jokushtetues nenin 7 të ligjit nr.2. Ajo konstatoi se duke i caktuar administratorëve disa detyra, si ndërprerjen e detyrimeve kontraktuale, menaxhimin e aktiviteve të biznesit dhe pronës së subjektit, ushtrimin e të drejtave të aksionarit dhe shitjen e pronës, i kishte hequr të gjitha të drejtat e pronës aksionarit të vetëm në kundërshtim me nenet 10 dhe 11 të ligjit për dispozitat kryesore kushtetuese. Meqenëse të drejta të tilla janë kompetencë vetëm e gjykatave vendase, kalimi i tyre tek administratorët kishte shkelur parimin kushtetues të ndarjes së kompetencave. Ajo argumentoi se neni 7 i ligjit nr.2 ishte në kundërshtim me nenin 3 të ligjit për dispozitat kryesore kushtetuese.

16. Më 19 nëntor 1997 u plotësua neni 10 i ligjit për dispozitat kryesore kushtetuese duke përfshirë të drejtën e shtetit për të kontrolluar dhe administruar pronën e subjekteve private siç është shoqëria ankuese. Si rezultat, po atë ditë, Parlamenti miratoi ndryshimin e ligjit për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë (ligji nr.3), duke rifutur formulimin e nenit 7 të mëparshëm jokushtetues të ligjit nr.2.

17. Më 24 nëntor 1997, Qeveria prishi vendimin e saj të datës 28 nëntor 1997 (shih paragrafin 12 më lart). Ajo përsëriti masën e administrimit të detyruar në lidhje me shoqërinë ankuese dhe caktoi D-në si administrator.

18. Më 31 janar 1998, D-ja i paraqiti Qeverisë raportin e saj të parë. Raportit iu shtuan tabelat e vlerësimit për asetet kryesore, rikthimet e planifikuara nga shitjet dhe pasqyrat financiare. Përmbledhja ekzekutive e raportit përmbante një paragraf me shkronja të zeza, i cili deklaronte (marrë nga versioni origjinal në anglisht):

“Rekomandimi i administratorëve është që të shiten asetet e shoqërisë. Kjo duhet bërë në mënyrën më të duhur për t'i siguruar kreditorëve rikthimin më të mirë brenda një periudhe kohore të arsyeshme”.

19. Më tej, raporti deklaronte se shoqëria ankuese kishte qenë një biznes i larmishëm i përbërë prej më shumë se 200 aktivitetesh në Shqipëri dhe aktivitete me kapital të përbashkët, si dhe agjenci në të paktën tetë vende të tjera. Shumë nga aktivitetet e saj ishin dëmtuar gjatë trazirave civile në pranverën e vitit 1997. Në përgatitjen e raportit nuk është kryer asnjë kontroll financiar i shoqërisë ankuese meqenëse nuk ishte pjesë e mandatit të tyre. D-ja deklaroi se informacioni financiar që u ishte siguruar atyre nga shoqëria apo palë të treta, duke përfshirë agjenci të ndryshme qeveritare, shpesh ishte i pasigurt dhe i paplotë për shkak të shkatërrimit të dokumenteve dhe regjistrave gjatë revoltave, zhdukjes së pretenduar

të librave dhe regjistrave të shoqërisë, refuzimit të disa palëve për të dhënë informacione përkatëse ose, kur kërkohej për të dhënë shpjegime për informacione apo të dhëna të dyshimta, dhe, dështimit të disa palëve për të ruajtur librat dhe regjistrat e duhur. Përveç kësaj, disa prona që supozoheshin në pronësinë e shoqërisë ankuese nuk mund të gjendeshin; ishin zbuluar prona të paregjistruara, disa prona ishin “pushtuar” dhe, për prona të tjera, pronësia pretendohej nga palë të treta. Më tej, të dhënat mbi pretendimet e mbledhura të kreditorëve vinin nga librat dhe regjistrat e pronarëve të shoqërisë, dhe jo nga vetë kreditorët.

20. Sipas konstatimeve kryesore të datës 30 nëntor 1997 për pozicionin financiar të shoqërisë ankuese, *inter alia*, argumentohej se shoqëria ankuese nuk ka vepruar asnjëherë me përfitim, se në të ardhmen e afërt nuk do të kishte para, nuk ishte në gjendje të përmbushte detyrimet e saj dhe ishte e paafte të paguante, bilanci i saj nuk pasqyronte fondet e marra nga kreditorët dhe librat dhe regjistrat e saj nuk përputheshin me njëri-tjetrin. Strategjia e propozuar për të rritur në maksimum rimëkëmbjen për kreditorët ishte shitja e asetëve të shoqërisë ankuese.

21. Më 6 mars 1998 Qeveria vendosi të kryejë një kontroll financiar të shoqërisë ankuese dhe caktoi pesë ekspertë kontabilistë individualë.

22. Më 25 mars 1998, Ministri i Financave ndryshoi termat e përcaktuar të kontratës që ishte përfunduar ndërmjet Qeverisë dhe administratorëve, D, sipas së cilës administratorët “do të bënin çdo përpjekje për të kthyer sa më shumë asete dhe biznese të fondeve për të likuiduar përpara datës 31 dhjetor 1998”. Kjo shënoi fillimin e fazës së dytë të shërbimeve të administratorëve.

23. Më 24 qershor 1998 Qeveria caktoi shoqërinë B si eksperte kontabiliste përveç ekspertëve kontabilistë individualë të caktuar me 6 mars 1998. Rrjedhimisht, më 5 janar 1999 B-ja paraqiti një raport. Sipas raportit, kishte qenë e pamundur për të përfutur ndonjë dokument deri më datën 28 korrik 1998. Për shkak të kësaj vonese, koha e kufizuar në dispozicion nuk lejonte B-në të kryente dhe plotësonte kontrollin financiar të shoqërisë.

24. Kontrolli financiar i shoqërisë ankuese duhej të bazohej vetëm në dokumentet e paraqitura nga grupi i mbikëqyrësve dhe administratorët, D, dhe duhej të përfundohej deri më 31 dhjetor 1998. Përpara vitit 1996 nuk është marrë asnjë dokument apo e dhënë financiare për shoqërinë meqenëse ishin shkatërruar gjatë revoltave në mars 1997. Përveç kësaj, nuk lejohej shqyrtimi i dokumenteve që ishin mbajtur nga prokuroria gjatë procedimeve kundër ankuesit individual, duke përfshirë dhjetë terminale kompjuterike. Prandaj, sipas raportit, rrjedhja e fondeve të siguruara nuk përfaqësonte saktësisht rrjedhjen aktuale të fondeve të shoqërisë, meqenëse “saktësia absolute, ndonëse e dëshirueshme, nuk mund të arrihet (dhe nuk do të arrihet) duke pasur parasysh informacionin në dispozicion”.

25. Raporti siguronte një përmbledhje të aktivitetëve vendase dhe ndërkombëtare, skemën organizative të saj dhe organizimin e sistemit të kontabilitetit dhe kontrollit financiar. Neni 4 përfshinte tabelën e rrjedhjes së fondeve. Raporti përfundonte duke deklaruar se “në fillimin e saj, dukej se shoqëria ishte angazhuar në biznes tregtar. Megjithatë pas marrjes së huave [drejt fundit të vitit 1994, në vitin 1995 dhe veçanërisht në vitin 1996], ajo filloi të shfaqte karakteristika të një skeme piramidale, në të cilën aktiviteti tregtar mori një rol dytësor në krahasim me depozitat. Në të vërtetë, niveli i të ardhurave nga aktivitetet tregtare nuk ishte dhe nuk mund të ishte i mjaftueshëm për të shlyer përqindjen e lartë të interesave dhe kapitalin e investuar nga depozituesit, pasi duhej të pranoheshin depozita të reja me qëllim që të shlyheshin depozituesit e mëparshëm”.

26. Më 30 korrik 1998 hyri në fuqi ligji për shitjen e pasurive të personave juridikë jobankarë, mbi bazën e të cilit çdo pronë që i përkiste personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë do të nxirreshin në shitje nga administratorët brenda të njëjtit vit. Për rrjedhojë, u shitën asetet dhe pasuritë e shoqërisë ankuese.

27. Më 28 nëntor 1998, hyri në fuqi Kushtetuta e Shqipërisë. Në një datë të pacaktuar, shoqëria ankuese, duke u bazuar në Kushtetutë, i kërkoi Gjykatës Kushtetuese të shpallte jokushtetues ligjin për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë dhe ligjin për shitjen e pasurive të personave juridikë jobankarë. Më 17 janar 1999, Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën për arsye se nuk ishte në përputhje me nenin 131 (f) dhe 134 të Kushtetutës, me sa duket për mungesë legjitimitimi (shih më poshtë “E drejta vendase përkatëse”).

28. Në një datë të pacaktuar, ka shumë të ngjarë në vitin 1999, administratorët paraqitën një raport financiar që korrespondonte me përfundimin e fazës së dytë, e cila ishte përqendruar në shitjen e pasurive të shoqërisë ankuese. Raporti përmbante, gjithashtu, një deklaratë të faturave dhe pagesave, një përmbledhje të rrjedhjes së fondeve dhe një deklaratë në lidhje me vlerësimin e rezultatit të datës 31 mars 1999.

29. Më 17 mars 2003 Parlamenti krijoi një komision hetimor për të shqyrtuar transparencën e procesit për administrimin dhe shitjen e pasurive që, *inter alia*, i përkiste shoqërisë ankuese. Opinioni kundërshtues i anëtarëve të komisionit hetimor që arrinte në 145 faqe, ishte mjaft kritik për të gjithë procesin, veçanërisht për procedurën jashtëgjyqësore të falimentimit që ishte ndjekur nga Qeveria.

30. Më 22 nëntor 2007 grupi i mbikëqyrësve njoftoi shoqërinë ankuese se procesi vazhdonte akoma dhe se asnjë vendim gjykate nuk ishte marrë akoma për të shpallur shoqërinë të falimentuar.

31. Më 29 mars 2010 grupi i mbikëqyrësve i dërgoi një letër Avokaturës së Shtetit. Sipas letrës shoqëria ankuese ishte certifikuar si një shoqëri që vepronte sipas një skeme piramidale në bazë të raportit të administratorëve. Me vendim të Këshillit të Ministrave koeficienti i shlyerjes për shoqërinë ankuese u përcaktua në masën njëmbëdhjetë për qind. Detyrimi debitor i shoqërisë ankuese arrinte në 34,361,781,170 lekë shqiptarë, që i detyrohej 73,509 kreditorëve në total. 57,742 kreditorë kishin përfituar nga shlyerja dhe procesi i likuidimit vazhdonte për pjesën tjetër 15,757, për një shumë totale prej 440,550,176 lekësh shqiptarë. Raporti përfundonte se po bëheshin përpjekje për riatdhesimin në Shqipëri të një numri depozitash të zbuluara në vende të huaja. Administrimi i detyruar i shoqërisë ankuese vazhdoi në përputhje me ligjet dhe nënligjet në fuqi.

#### C. Procedimet penale ndaj ankuesit individual

32. Më 12 prill 1998 administratorët kërkuan që ankuesi individual të ndiqej penalisht për mashtrim. Më 28 prill 1998 prokurori akuzoi ankuesin individual për mashtrim. Ankuesi individual u arrestua po atë ditë.

33. Më 10 mars 1999 prokurori vendosi të caktonte tre ekspertë për të përgatitur një raport financiar kontabiliteti të shoqërisë ankuese.

34. Më 21 prill 1999 ekspertët paraqitën raportin e tyre, sipas të cilit numri i kreditorëve ishte 68,857 dhe detyrimet totale të shoqërisë ankuese ishin 32,060,884,036 lekë shqiptarë, të barabarta me 325,029,238 dollarë amerikanë. Vlerësimet e tyre u bazuan në informacionin që ishte depozituar dhe përpunuar nga grupi i mbikëqyrësve. Ato nuk u bazuan në raportin e dhënë nga shoqëria kontrolluese e caktuar nga Qeveria më 24 qershor 1998.

35. Nëpërmjet një vendimi të hollësishëm të datës 31 maj 2000 Gjykata e Rrethit e shpalli ankuesin fajtor për mashtrim dhe e dënoi atë me 5 vjet burgim. Ankuesi dhe prokurori apeluan në një datë të pacaktuar në qershor 2000.

36. Në një datë të pacaktuar në maj 2001, Gjykata e Apelit caktoi tre ekspertët e njëjtë për të bërë një raport tjetër financiar.

37. Më 17 tetor 2001 ekspertët paraqitën raportin e tyre. Sipas raportit, numri total i kreditorëve ishte 57, 923 dhe detyrimi i përgjithshëm arrinte në 29,249,622,461 lekë shqiptarë, të barabartë me 199,045,000 dollarë amerikanë në atë kohë. Kjo e dhënë është marrë nga kompjuterët e shoqërisë ankuese, të cilët ishin sekuestruar nga prokuroria. Duke iu referuar numrit të pretendimeve të bëra nga kreditorët pas fillimit të procedurave të administrimit të detyruar, raporti tregonte se numri i përgjithshëm i kreditorëve ishte 38,652, ndërsa detyrimi në total ishte 127,019,677 dollarë amerikanë.

38. Për sa i përket vlerës së aseteve të shoqërisë ankuese, raporti përfundonte se, deri më 27 qershor 1997, asetet e saj arrinin në shumën 336,563,915 dollarë amerikanë. Ky vlerësim është bazuar në një vendim të Gjykatës së Rrethit të datës 27 qershor 1997, i cili rendiste pasuritë e shoqërisë dhe vlerën monetare përkatëse. Megjithatë, raporti zbriti vlerën e minierave dhe burimeve minerale<sup>1</sup>.

39. Pas fillimit të procedurave të administrimit të detyruar vlera totale e aseteve të shoqërisë ankuese arriti në 14,683,493 dollarë amerikanë, nga të cilat 8,675,975 dollarë amerikanë përbëheshin nga të ardhurat nga shitjet e aseteve dhe 6,007,513 dollarë amerikanë ishte vlera e llogaritur e aseteve që nuk ishin shitur akoma.

---

<sup>1</sup> Vendimi i Gjykatës së Rrethit i datës 27 qershor 1997 vendosi të pranonte kërkesën e bërë nga shoqëria ankuese për rritjen e kapitalin të saj në shumën 797,816,311,000 lekë (përafërsisht të barabartë me 5,147,202,006 dollarë amerikanë sipas kursit të këmbimit në kohën përkatëse).

40. Për sa i përket rrjedhjes së fondeve në llogaritë bankare të shoqërisë ankuese, raporti përfundonte se bilanci i saj ishte 11,533,063 dollarë amerikanë. Megjithatë, jo të gjitha bankat e përfshira kishin paraqitur raportet e rrjedhjes së fondeve. Detyrimi debitor që palët e treta i detyroheshin shoqërisë ankuese ishte llogaritur 18,453,348 dollarë amerikanë. Raporti vlerësoi dëmin e aseteve të shoqërisë ankuese si rezultat i trazirave civile të vitit 1997 në shumën 201 milionë dollarë amerikanë.

41. Më 24 dhjetor 2001 Gjykata e Apelit u bazua në fakte të njëjta të paraqitura në vendimin e Gjykatës së Rrethit. Ajo konstatoi se ankuesi individual ishte përgjegjës për mashtrimin e 57,923 kreditorëve në shumën totale prej 29,249,622,461 lekësh shqiptarë. Gjykata shpjegoi rënien në numrin e përgjithshëm të kreditorëve dhe shumën totale të detyrimit nga zbritja e interesit të kapitalizuar dhe përjashtimi i regjistrave të pasaktë. Më tej, gjykata rrëzoi të dhënat që rridhnin nga fakti se procedurat e administrimit të detyruar ishin të pasakta, duke pasur parasysh faktin se jo të gjithë kreditorët mund të kenë paraqitur pretendimet e tyre.

42. Gjykata e Apelit e dënoi ankuesin individual me njëzet vjet burgim në përputhje me nenin 143 § 2 të Kodit Penal, i cili kishte hyrë në fuqi më 24 janar 2001.

43. Më 22 janar 2002 ankuesi individual apeloj.

44. Më 22 nëntor 2002 Gjykata e Lartë e shpalli ankuesin individual fajtor sipas akuzës. Duke u bazuar në fakte të njëjta me ato të përshkruara në vendimet e gjykatave më të ulëta, Gjykata e Lartë argumentoi se veprimet e ankuesit individual dhe aktivitetet e shoqërisë ankuese kishin qenë të pasakta dhe të paligjshme. Ajo la në fuqi konstatimet e Gjykatës së Apelit në lidhje me numrin total të kreditorëve, pra 57,923. Megjithatë ajo përfundoi se shuma totale e detyrimeve të ankuesit ishte 22,374,141,130 lekë shqiptarë (përafërsisht 157,453,000 dollarë amerikanë në atë kohë), pasi kishte zbritur rrjedhjen e fondeve të shoqërisë, e cila arrinte në shumën 6,875,481,331 lekë shqiptarë.

45. Në marrjen e vendimit për ankuesin individual, Gjykata e Lartë arsyetoi se ai duhej të shpallej përgjegjës penalisht për një numër akuzash të njëjtë me numrin e përgjithshëm të kreditorëve, pra 57,923, në përputhje me nenin 141 § 1 të Kodit Penal, i cili parashikonte një periudhë burgimi prej 5 vjetësh. Për pasojë, ajo e dënoi ankuesin individual me njëzet vjet burgim.

46. Një përshkrim i hollësishëm i fakteve në lidhje me procedimet penale ndaj ankuesit individual mund të gjendet në çështjen Alimuçaj kundër Shqipërisë, nr.20134 § 05, komunikuar më 7 dhjetor 2009.

D. Derogimi (shmangia e përkohshme) i Shqipërisë nga detyrimet e saj sipas Konventës

47. Nëpërmjet notës verbale të datës 4 mars 1997, e cila është regjistruar pranë Sekretariatit të Përgjithshëm më 10 mars 1997, Ministria Shqiptare e Punëve të Jashtme, në përputhje me nenin 15 të Konventës, njoftoi Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës mbi synimin e Qeverisë për të deroguar nga detyrimet e saj sipas Konventës. Sipas notës verbale kufizime ishin caktuar *inter alia* në të drejtën e mbledhjes, lirinë e shtypit dhe informimit, si dhe në lëvizjen e lirë të njerëzve. Asnjë kufizim nuk ishte caktuar në të drejtën për pronën.

48. Nëpërmjet notës verbale të datës 26 korrik 1997, të regjistruar pranë Sekretariatit të Përgjithshëm më 24 tetor 1997, Ministria Shqiptare e Punëve të Jashtme njoftoi Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës se Qeveria po tërhiqte njoftimin e saj të derogimit sipas nenit 15 të Konventës.

C. E drejta dhe praktika përkatëse vendase

1. Ligji për dispozitat kryesore kushtetuese nr.7491, datë 29 prill 1991, ndryshuar me ligjin nr.8255, 19 nëntor 1997

49. Deri në miratimin e Kushtetutës në vitin 1998, ligji për dispozitat kryesore kushtetuese ishte ligji bazë në Shqipëri. Neni 3 parashikonte ndarjen e pushteteve (legjislativi, ekzekutivi dhe gjyqësori). Neni 10, i cili parashikonte të drejtën e iniciativës ekonomike, citohet si më poshtë:

“Ekonomia e vendit bazohet në shumëllojshmërinë e pronave, iniciativën e lirë të të gjitha subjekteve ekonomike dhe në rolin rregullues të shtetit.

Iniciativa ekonomike e personave juridikë dhe fizikë nuk mund të zhvillohet në kundërshtim me interesin shoqëror dhe nuk duhet të cenojë sigurinë, lirinë dhe dinjitetin e njeriut”.

50. Neni 11 njihte gëzimin e së drejtës së pronës.

51. Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese të datës 13 nëntor 1997 (shih paragrafin 15 më lart), nenit 10 të ligjit për dispozitat kryesore kushtetuese iu shtuan paragrafët e mëposhtëm më 19 nëntor 1997:



“Veprimtaria e kundërligjshme e subjekteve private që prek në masë interesat e individëve dhe grupeve sociale, që është në kundërvënien e në dëm të parimeve të ekonomisë së tregut e të politikave ekonomike e financiare kombëtare e ndërkombëtare, që cenon stabilitetin ekonomik e social të vendit, vihet nën kontrollin dhe administrimin e institucioneve publike kombëtare dhe ndërkombëtare të specializuara.

Shkalla e ndërhyrjes, si dhe kompetencat e kontrollit dhe të administrimit të këtyre subjekteve private nga ana e institucioneve të lartpërmendura, përcaktohet me ligj.

Në këto raste shteti ka të drejtë dhe detyrë të disponojë mbi pasurinë e subjekteve private vetëm në mbrojtje të interesave të të dëmtuarve.

Askujt nuk mund t’i mohohet e drejta për t’u ankuar në gjykatë kundër masave të kontrollit, të administrimit e të disponimit të pasurisë së tij, si dhe për të kërkuar shpërblimin e plotë të dëmeve të shkaktuara”.

Opinionit 9/1998 i Nënkomisionit mbi Reformat Kushtetuese të Komisionit European për Demokraci nëpërmjet ligjit (Komisioni i Venecias) datë 15 prill 1998.

52. Më 15 prill 1998 nënkomisioni i Komisionit të Venecias mbi Reformat Kushtetuese miratoi një opinion për ndryshimet e kryera të ligjit për dispozitat kryesore kushtetuese më 19 nëntor 1997. Sipas opinionit, ndryshimi kushtetues *ad hoc* kishte qëllim legjitim dhe mund të kërkohej nga nevoja të përkohshme specifike. Megjithatë, opinionit deklaroi se neni i parë i amendamentit, i cili parashikonte bazën për ndërhyrjen e shtetit, përdori një numër të madh konceptesh të gjera, të cilave ishte shumë e vështirë për t’i dhënë një kuptim të saktë ligjor. Sipas opinionit, teksti *ad hoc*, i cili iu përgjigj nevojës urgjente sociale të momentit, nuk ishte i përshtatshëm si parim afatgjatë i rendit kushtetues shqiptar. Ai paralajmëroi kundër përdorimit të përsëritur të këtyre ndryshimeve kushtetuese *ad hoc* në fushën e rregullimit ekonomik dhe vlerësoi se teksti i zgjedhur nuk duhej të integrohej meqenëse ishte në Kushtetutën e ardhshme të Shqipërisë.

## 2. Kushtetuta e Shqipërisë

53. Kushtetuta e Shqipërisë hyri në fuqi më 28 nëntor 1998. Ajo shfuqizoi ligjin për dispozitat kryesore kushtetuese siç paraqitet më lart. Dispozitat përkatëse citohen si më poshtë:

### Neni 131

“Gjykata Kushtetuese vendos për:

a) pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, siç parashikohet në nenin 122.

...

f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave”.

### Neni 134 §§ 1 (f) dhe 2

“1. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje vetëm me kërkesë të:

...

f) partive politike dhe organizatave të tjera

g) individëve.

2. Subjektet e parashikuara në paragrafin e parë, shkronjat ...(f) dhe (g) mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre.

## 3. Kodi Civil

54. Neni 1050 i Kodit Civil (KC) parashikon:

“Me kontratën e huas njëra palë (huadhënësi) i jep në pronësi palës tjetër (huamarrësit) një shumë të hollash ose sende që përcaktohen në numër, me peshë ose me masë dhe huamarrësi detyrohet t’i kthejë huadhënësit aq të holla, ose aq sende të atij lloji dhe të asaj cilësie, brenda afatit të caktuar në kontratë ose, kur nuk është caktuar afat, me kërkesën e huadhënësit”.

#### 4. Kodi i Procedurës Civile

55. Nenet 324-333 rregullojnë gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

56. Neni 326, në fuqi në kohë materiale, parashikonte se asnjë padi nuk mund të ngrihet kundër akteve administrative të Qeverisë kur ato përmbajnë një detyrim të përgjithshëm, në qoftë se nuk shkelin të drejtat dhe interesat e ligjshme të qytetarëve.

5. Ligji i falimentimit (ligji për procedurat e falimentimit nr.8017, datë 25 tetor 1995)

57. Ligji i falimentimit, në fuqi në kohë materiale, zbatohet për personat juridikë të cilët, si shoqëria ankuese ishin krijuar në përputhje me ligjin e shoqërive. Për procedurat që duhej të filloheshin duke u bazuar në akuzën ligjore të kreditorit, ai ose ajo duhej të provonin se debitori nuk kishte përmbushur detyrimet për pagesat. Në çdo rast, debitori, gjithashtu, mund të depozitonte një akuzë të ngjashme. Procedurat e falimentimit ishin procedurat e gjykatës. Rrjedhimisht, vendimi për t'i deklaruar ato të hapura ishte në kompetencën e gjykatës së rrethit, e cila mund të vendoste debitorin në administrim të detyruar duke caktuar një administrator. Gjatë kryerjes së detyrave të tij, administratori vepronte nën mbikëqyrjen e gjykatës, e cila kishte të drejtë ta zëvendësonte administratorin për shkaqe të bazuara dhe të arsyeshme. Ligji i falimentimit parashikonte miratimin e një plani ristrukturimi, që kërkonte aprovimin e gjykatës. Në rast se plani i ristrukturimit nuk pranohej, gjykata vendoste vazhdimin e likuidimit të menjëhershëm të asetëve të debitorit. Ligji i falimentimit parashikonte të drejtën e apelimit kundër vendimit të gjykatës së rrethit.

6. Ligji për ndalimin e skemave piramidale (ligji për ndalimin e skemave piramidale mashtruese të huamarrjes, ligji nr.8188, datë 23 janar 1997).

58. Ligji parashikonte se huamarrja e organizuar në bazë të skemave piramidale mashtruese është veprimtari e paligjshme. Organizimi dhe vënia në funksionim e skemave piramidale mashtruese të huamarrjes, përbënte shkelje ligjore dhe dënohej me jo më pak se njëzet vjet burgim dhe me konfiskim të pasurisë së luajshme dhe të paluajshme.

7. Ligji për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë (ligji për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë, ligji nr.8215, datë 9 maj 1997 (ligji nr.1), ndryshuar me ligjin nr.8277, datë 30 korrik 1997 (ligji nr.2), ligji nr.8256, datë 19 nëntor 1997 (ligji nr.3), ligji nr.8347, datë 18 maj 1998 (ligji nr.4) dhe ligji nr.9835 datë 22 nëntor 2007 (ligji nr.5))

a) Ligji nr.1

59. Neni 1 deklaronte se shoqëritë tregtare dhe personat e tjerë juridikë a fizikë të cilët në forma dhe mënyra të ndryshme kanë marrë hua nga publiku, duhej të ishin objekt i kontrollit financiar në lidhje me pozicionin e tyre financiar, numrin e kreditorëve, me detyrimet financiare për t'u paguar, me lëvizjen e parave, si dhe me gjendjen e parave në arkë dhe depozitat në banka brenda dhe jashtë vendit, nga një grup ekspertësh financiarë të caktuar nga Qeveria në përputhje me ligjin nr.1.

60. Neni 2 krijoi një grup mbikëqyrës me tre anëtarë për të mbikëqyrur të gjithë procesin. Grupi i mbikëqyrësve bashkërendonte marrëdhëniet ndërmjet grupit të ekspertëve dhe subjekteve që i nënshtrohen ligjit nr.1 në përputhje me nenin 3 dhe i raportonte Këshillit të Ministrave.

61. Sipas nenit 4 ekspertët financiarë kontrollonin librat dhe regjistrat e shoqërisë, kontratat e lidhura me kreditorët dhe dokumente të tjera përkatëse. Neni 6 përcaktonte se raportet përfundimtare të grupit të ekspertëve i paraqiteshin organeve përkatëse shtetërore, duke përfshirë Prokurorinë e Përgjithshme.

62. Ligji nr.1 nuk parashikonte mundësinë e kontrollit gjyqësor.

b) Ligji nr.2

63. Neni 4 paraqiste objektin e ligjit nr.2. Të gjithë ata individë, persona fizikë a juridikë, të cilët kanë marrë hua nga publiku i nënshtroheshin kontrollit financiar, me përjashtim: të një banke të licencuar nga Banka e Shqipërisë në përputhje me legjisllacionin në fuqi; të një shoqërie, e cila emetonte letra me vlerë për investime në përputhje me legjisllacionin në fuqi; të një personi fizik, i cili kishte marrë hua në përputhje me parashikimet e Kodit Civil, por që të plotësonte njëkohësisht tre kushte.

64. Sipas nenit 5, Qeveria caktoi administratorët për subjektet që i nënshtroheshin kontrollit financiar. Administratorët duhej të ishin persona fizikë ose subjekte juridikë. Administratorët caktoheshin nëse plotësoheshin kushtet vijuese: a) Subjekti i kontrollit ishte në gjendjen e paaftësisë paguese, ose nëse verifikohej se rrezikohej për t'u ndodhur në gjendjen e paaftësisë paguese; b) subjekti i kontrollit kishte pezulluar, ose ishte gati të pezullonte pagesat, apo nuk kishte mundësi të shlyente detyrimet e tij në momentin që ato duhej të përmbusheshin sipas akteve të lidhura prej tij me persona të tretë; c) veprimtaria e subjektit të kontrollit ishte në kundërshtim me parimet dhe rregullat e njohura financiare; d)

gjendja në të cilën ndodhej subjekti i kontrollit ishte në kundërshtim me parimet dhe rregullat e njohura financiare; e) ishte në interes publik që subjekti i kontrollit ose personat e lidhur me të të ishin subjekte të këtij ligji për shkak se kishin tërhequr në favor të tyre pasuri të personave të tretë.

65. Subjekti i kontrollit kishte të drejtë të apelonte brenda dhjetë ditëve pranë Gjykatës Kushtetuese kundër caktimit të administratorëve. Nëse Gjykata e Apelit linte në fuqi apelin, ajo urdhëronte Këshillin e Ministrave për të ndërprerë masën e administrimit të detyruar. Dhënia e vendimit të gjykatës (në rastin kur ajo prishte vendimin e Qeverisë) nuk e pengonte Qeverinë në marrjen e një vendimi tjetër për caktimin e administratorëve të tjerë në lidhje me subjektin e kontrollit, me kusht që të veprohej në përputhje me ligjin.

66. Sipas nenit 7, administratorët e caktuar nga Qeveria, *inter alia*, kishin detyrat e mëposhtme: të pezullonin tërësisht apo pjesërisht ripagimin e ndonjë huaje apo detyrimi palëve të treta; të menaxhonin veprimtarinë dhe pasurinë e subjektit të kontrollit; të ushtronin të gjitha të drejtat e aksionarit, ortakut, si dhe personelit administrativ të tyre; të shisnin apo të dispononin në mënyrë ligjore pasurinë e subjektit të kontrollit në kushtet që ai e konsideronte të arsyeshme; të konfiskonin asetet e individëve të emëruar të lidhur me skemat; dhe të caktonin ekspertë për të zbuluar asetet jashtë vendit.

67. Neni 11 parashikonte se administratorët mund të shkarkoheshin nga pozicioni i tyre nga Qeveria sipas kushteve të caktuara. Sipas nenit 15, administratorët duhej t'i paraqisnin Qeverisë raporte të rregullta mbi ecurinë e punës.

68. Ligji nuk parashikonte mjete ligjore në dispozicion të subjekteve jobankare për të kundërshtuar veprimet e administratorëve.

c) Ligjet nr.3-5

69. Pas përfshirjes së paragrafit të ri në nenin 10 të ligjit për dispozitat kryesore kushtetuese (shih më lart), neni 1 i ligjit nr.3 të vitit 1997 rifuti formulimin e nenit 7 të ligjit nr.2 të vitit 1997, i cili ishte prishur me vendim të Gjykatës Kushtetuese të datës 13 nëntor 1997 (shih paragrafët 15-16 më lart).

70. Neni 1 i ligjit nr.4 parashikonte se “në rastet kur shoqëritë i nënshtrohen kontrollit financiar dhe administrimit të detyruar sipas ligjit, autoritetet gjyqësore nuk dëgjojnë asnjë padi civile dhe pezullojnë të gjitha procedurat e zbatueshme në lidhje me vendimet e mëparshme të miratuara.”

71. Neni 1 i ligjit nr.5 parashikonte se grupi i mbikëqyrësve duhej t'i raportonte Ministrit të Financave.

8. Ligji për shitjen e pasurive të personave juridikë jobankarë (ligji për mënyrën dhe procedurat e shitjes së pasurive të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë, ligji nr.8386, datë 30 korrik 1998, ndryshuar me ligjin nr.9553, datë 5 qershor 2006).

72. Neni 1 autorizonte administratorët e subjekteve ligjore jobankare të kryenin veprimet e shitjes së pasurive të këtyre subjekteve dhe pronarëve të tyre, si dhe të pjesëtarëve të tjerë të familjeve të tyre. Të ardhurat do të përdorreshin për t'i siguruar publikut kompensimin monetar gjatë procesit të rishpërndarjes. Sipas nenit 3 ish-presidentët e shoqërive huamarrëse që i nënshtroheshin ligjit për kontrollin financiar të personave ligjorë jobankarë, nuk kishin të drejtë që pas shitjes së pasurisë ta riblinin atë apo të kërkonin në gjykatë të drejtën për rikthimin e saj.

73. Neni 4 përcaktonte se administratorët ishin përgjegjës për shitjen e pasurisë dhe për të vendosur për procedurat. Çmimi fillestar i shitjes përcaktohej nga një grup vlerësimi sipas nenit 9. Çdo person fizik apo subjekt ligjor, vendas ose i huaj, mund të merrte pjesë në shitjen e pasurisë në përputhje me nenin 5. Sipas nenit 6 të ligjit 1998 shitja duhej të bëhej në një nga format e parashikuara me ligj: shitje direkte, ankand ose tender publik. Sipas ligjit të vitit 2006, shitja u krye në formën e ankandit. Neni 11 i ligjit 1998 parashikoi se procesi duhej të përfundonte, në parim, para fundit të vitit 1998. Sipas ligjit të vitit 2006, pasuria që nuk ishte shitur deri më 31 dhjetor 2005 do të vihej për shitje nga Ministria e Financave.

74. Neni 14 parashikonte se vetëm ekspertët kontabël kishin të drejtë të kërkonin shpalljen e shitjes të pavlefshme nga gjykata. Kërkesa duhej të bëhej brenda 30 ditëve nga data kur ato konstatonin shkelje të dispozitave të ligjit.

9. Ligji për rishpërndarjen e pasurive të personave juridikë jobankarë (ligji për kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes së pasurisë së personave juridikë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë, ligji nr.8360, datë 10 qershor 1998 ndryshuar me ligjin nr.9935, datë 26 qershor 2008).

75. Neni 3 përcaktonte se shpërndarja e vlerave financiare të subjekteve jobankare duhej të bëhej sipas koeficientit të kthimit, i cili ndryshonte për çdo subjekt. Në përputhje me nenin 4, koeficienti duhej të llogaritej si raport i shumës së vlerave ekzistuese monetare në llogaritë bankare të personave juridikë

jobankarë dhe të ardhurave të siguruara nga shitja e pasurisë së tyre me shumën e detyrimit debitor që personat juridikë jobankarë u kishin kreditorëve të tyre.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.52, datë 28 janar 2005

76. Më 28 janar 2005, Qeveria miratoi një vendim për shpërndarjen e vlerave financiare kreditorëve të shoqërisë ankuese mbi bazën e një koeficienti të caktuar. Sipas vendimit, koeficienti i shpërndarjes për kreditorët ishte llogaritur në masën njëmbëdhjetë për qind. Të ardhurat e mbledhura nga shitja e vlerave arrinin në 3,800,000,000 lekë shqiptarë (përafërsisht 26,620,100 euro). Detyrimi debitor i shoqërisë mbeti 34,361,781,170 lekë shqiptarë (përafërsisht 240,714,000 euro).

10. Ligji për detyrimet debitorë (ligji për nxjerrjen e detyrimeve debitorë dhe rikthimin e vlerave pasurore në llogaritë e personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë nr.8471, datë 8 prill 1999).

77. Neni 4 parashikonte se administratorët duhej të identifikonin të gjithë personat fizikë e juridikë që kishin detyrime debitorë ndaj personave jobankarë subjekt i ligjit për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë. Sipas nenit 5 administratorët duhej të miratonin një vendim për personat që do të deklaroheshin debitorë dhe vlerat financiare dhe pasurore debitorë që ato duhej të kthenin në llogaritë bankare të personave juridikë jobankarë. Ky vendim përbënte një titull ekzekutiv dhe ishte i zbatueshëm. Neni 7 i lejonte debitorëve 45 ditë afat nga data e njoftimit të vendimit të administratorëve për të përmbushur detyrimet e tyre; dështimi i debitorëve për të përmbushur detyrimin, rezultonte në ekzekutimin e detyrueshëm nga zyra e përmbarimit.

78. Sipas nenit 8, pala e dëmtuar kishte të drejtën të kundërshtonte vendimin e administratorëve dhe veprimet e zyrës së përmbarimit para Gjykatës së Apelit respektivisht brenda dhjetë dhe pesë ditëve.

Vendimi i administratorëve nr.30, datë 31 gusht 1999

79. Më 31 gusht 1999 administratorët e shoqërisë ankuese miratuan një vendim në lidhje me emrat e debitorëve të shoqërisë. Vendimit iu shtua një listë me emrat e 25 debitorëve dhe detyrimet e tyre debitorë përkatëse. Në listë përfshihej emri i ankuesit individual me një detyrim debitor në shumën 171,924,300 lekë shqiptarë (përafërsisht 1,204,380 euro).

#### ANKIMI

80. Ankuesit u ankuan sipas nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës për ndërhyrjen e pajustificuar të shtetit në gëzimin paqësor të zotërimeve të tyre dhe shmangien e gjyqësorit në mbikëqyrjen e veprimeve të shtetit.

#### E DREJTA

81. Ankuesit u ankuan për shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës.

##### A. Parashtrimet e palëve

##### 1. Qeveria

82. Qeveria argumentoi se, meqenëse shoqëria ankuese ishte në administrim, as shoqëria dhe as ankuesi nuk mund të pretendonin se ishin "viktimë" në kuptim të nenit 34 të Konventës. Për më tepër, ankuesi individual kishte detyrime ndaj kompanisë.

83. Sipas mendimit të Qeverisë, ankuesi individual nuk kishte kundërshtuar vendimin e Qeverisë të datës 28 tetor 1997 (*shih paragrafin 12 më lart*). Akuza e tij kundër vendimit të datës 22 korrik 1997 kishte provuar se ishte efektive për këtë qëllim. Për më tepër, ai nuk kishte kundërshtuar të njëjtin vendim në përputhje me nenin 326 të Kodit të Procedurës Civile, dhe as nuk kishte depozituar ankim kushtetues në përputhje me ligjin e Gjykatës Kushtetuese. Nëse do të kishte vepruar kështu, gjykatat vendase do të kishin miratuar një vendim për ligjshmërinë e ndërhyrjes së shtetit. Për arsyet e mësipërme, Qeveria vlerësoi se ankimi ishte parashtruar jashtë afatit gjashtëmuor.

84. Qeveria parashtrroi se shoqëria ankuese nuk kishte zotërimë ekzistuese në kuptim të nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës. Sipas mendimit të saj, neni 1 i protokollit nr.1 mbronte të drejtën e pronës në lidhje me asetet që rridhnin nga të drejtat legjitime të individëve dhe jo asetet e prokuruar në mënyrë të paligjshme duke u bazuar në përvetësimin e padrejtë të të tjerëve. Pjesa më e madhe e aseteve të shoqërisë ishte krijuar duke u bazuar në paratë e marra hua nga kreditorët duke pasur parasysh se shoqëria nuk funksiononte me përfitim.

##### 2. Ankuesit

85. Ankuesit parashtruan se çdo përpjekje për të kundërshtuar vendimin e Qeverisë të datës 28 tetor 1997 do të ishte e paefektshme duke pasur parasysh zëvendësimin e gjyqësorit nga Qeveria në

vënien e shoqërisë ankuese në administrim të detyruar. Ato theksuan vendimin e Gjykatës së Apelit të datës 17 shtator 1997, të cilin Qeveria nuk e kishte marrë parasysh duke caktuar të njëjtët administratorë, në kundërshtim me konstatimet e gjykatës. Për më tepër, aktet ligjore në fuqi, nuk i ngarkonin administratorët me përgjegjësi për ndonjë dëm të pariparueshëm shkaktuar shoqërisë gjatë kryerjes së detyrave të tyre.

86. Ankuesit deklaruan se vendimi i Gjykatës Kushtetuese i datës 13 nëntor 1997 në favor të tyre nuk ishte respektuar nga Qeveria. Gjashtë ditë pas vendimit të gjykatës, Qeveria kishte ndryshuar ligjin për dispozitat kryesore kushtetuese dhe kishte rifutur të njëjtën dispozitë që ishte deklaruar jokushtetuese nga ajo gjykatë. Prandaj ankuesit pretenduan se veprimet e Qeverisë dhe legjislativi i kishin bërë mjetet ligjore vendase të paefektshme.

87. Për sa i përket raportit të administratorëve të datës 31 janar 1998 dhe raportit të kontrollit financiar të datës 5 janar 1999, ankuesit deklaruan se ato nuk ishin njoftuar për përmbajtjen e tyre deri në konstatimet e komisionit hetimor parlamentar të vitit 2003. Edhe nëse ato do të njoftoheshin dhe do të kundërshtonin këto konstatime, përsëri nuk do të kishin një perspektivë të arsyeshme për sukses.

88. Më tej, ankuesit parashtruan se, me hyrjen në fuqi të Kushtetutës, ato kishin kundërshtuar në mënyrë të pasuksesshme kushtetutshmërinë e ligjit për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë dhe ligjit për shitjen e pasurisë së personave juridikë jobankarë.

#### B. Vlerësimi i Gjykatës

##### 1. Papajtueshmëria e pretenduar *ratione personae* dhe *ratione materiae*

89. Gjykata përsërit se termi “viktimë” në nenin 34 të Konventës tregon personin e prekur drejtpërdrejt nga ligji apo mosveprimi i tij për çështjen në shqyrtim (*shih Eckle kundër Gjermanisë, 15 korrik 1982, § 66, seria A nr.51*). Në vendimin e saj Agrotexim dhe të tjerë kundër Greqisë (24 tetor 1995 § 66, seria A nr.330-A), Gjykata argumentoi se, në parim, një shoqëri duhej t'i drejtohej institucioneve të Konventës nëpërmjet organeve të saj ligjore ose, në rastin e likuidimit, nëpërmjet likuiduesve të saj. Vetëm në rrethana të veçanta, veçanërisht kur përcaktohej qartë se ishte e pamundur që shoqëria të drejtohej nëpërmjet likuiduesve të saj, atëherë ankimi mund të depozitohet në emër të saj nga të tjerë, për shembull nga aksionarët e saj, me kusht që të jenë prekur të drejtat e tyre individuale.

90. Gjykata me tej përsërit se Konventa dhe protokollet e saj duhet të interpretohen se garantojnë të drejtat që janë praktike dhe efektive në kundërshtim me ato teorike dhe iluzive. Ky parim është, gjithashtu, i zbatueshëm për nenin 34 të Konventës, i cili u jep individëve dhe organizatave joqeveritare të drejtën e natyrës procedurale (*shih Banka Kapitale AD kundër Bullgarisë (dec.), nr.49429/99, 9 shtator 2004, dhe Banka Industriale dhe e Kreditit kundër Republikës Çeke, nr.29010/95, § 48, GJEDNJ 2003-XI (ekstrakte)*).

91. Në rastin konkret, Gjykata vëren se, kur është depozituar ankimi para saj më 2 qershor 2005, shoqëria ankuese ishte vënë tashmë në administrim të detyruar. Prandaj, administratorët kishin të drejtë t'i drejtoheshin Gjykatës në emër të shoqërisë ankuese nëse ato e konsideronin me vend. Megjithatë ankimi para Gjykatës lidhet saktësisht me ngjarjet komplekse që shpiten në caktimin e administratorëve, rolin e tyre dhe kryerjen e procedurave të administrimit të detyruar. Ankimi nuk lidhet me ndërhyrjen e pretenduar në të drejtën e pronës të shoqërisë ankuese, të cilën administratorët ishin caktuar të mbrojnë dhe menaxhojnë dhe në lidhje me të cilën administratorët mund t'i drejtoheshin institucioneve të Konventës në emër të shoqërisë ankuese.

92. Prandaj ekziston një konflikt i qartë interesi ndërmjet shoqërisë ankuese dhe administratorëve në lidhje me ankimin para Gjykatës, duke qenë e pamundur që shoqëria ankuese t'i drejtohej Gjykatës nëpërmjet tyre (*shih Camberrow MM5 AD kundër Bullgarisë (dec.), nr.50357/99, 1 prill 2004, dhe Roseltrans, Finlease dhe Myshkin kundër Ruisë (dec), nr.60974/00, 27 maj 2004*). Të argumentosh se vetëm administratorët ishin të autorizuar të përfaqësonin shoqërinë ankuese në depozitim të ankesave të tilla para Gjykatës, do të thotë të bësh teorike dhe iluzive të drejtën e petitionit individual dhënë nga neni 34 (*shih Banka Industriale dhe e Kreditit, cituar më lart § 51*).

93. Gjykata thekson se ankuesi individual ishte aksionari i vetëm i shoqërisë ankuese që nga themelimi i saj në vitin 1992. Aksionet e ankuesit padyshim kishin vlerë ekonomike dhe përbënin “zotërime” në kuptim të nenit 1 të protokollit nr.1 (*shih Marini kundër Shqipërisë, nr.3738/02, § 164, GJEDNJ 2007-XIV (ekstrakte), dhe Sovtransavto Holding kundër Ukrainës (dec.), nr.48553/99, 27 shtator 2001*). Ankuesi individual e kryente biznesin e tij nëpërmjet shoqërisë dhe për rrjedhojë kishte interes direkt personal në objektin e ankimit (*shih G.J kundër Luksemburgut, nr.21156/93 § 24, 26 tetor 2000*). Të argumentosh se ankuesi individual nuk kishte zotërime ekzistuese në kohën e paraqitjes së

ankimit do të thotë të dëmtosh vetë thelbin e të drejtës së ankimit individual, meqenëse do të nxiste qeveritë të privonin këta individë nga e drejta e pronës së tyre dhe, në të njëjtën kohë, nga mundësia për t'u ankuar për këtë çështje pranë Gjykatës.

94. Rrjedhimisht Gjykata konstaton se, duke pasur parasysh natyrën e veçantë të ankimeve të bëra, ekzistonin rrethana të veçanta të cilat i jepnin të drejtën ankuesit individual, i cili ishte presidenti dhe aksionari i vetëm i shoqërisë ankuese dhe kishte “zotërime”, të depozitonte një ankim të vlefshëm në emër të tij dhe të shoqërisë ankuese.

95. Kundërshtimet e Qeverisë në lidhje me papajtueshmërinë *ratione personae dhe ratione materiae* duhet të rrëzohen.

### 2. Mosshterimi i pretenduar i mjeteve ligjore vendase

96. Gjykata përsërit se rregulli i shterimit të mjeteve ligjore vendase referuar në nenin 35 të Konventës detyron të gjithë personat që paraqesin çështjet e tyre kundër shtetit para Gjykatës të përdorin së pari mjetet ligjore të siguruar nga sistemi ligjor kombëtar (*shih Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar, 7 dhjetor 1976, § 48, seria A nr.24*). Rekursi duhet të bëhet nga një ankues me mjete ligjore që janë në dispozicion dhe të mjaftueshme për të gjetur zgjidhje në lidhje me shkeljet e pretenduara. Ekzistenca e mjeteve ligjore në fjalë duhet që të jetë e sigurt në mënyrë të mjaftueshme jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, pasi dështimi në përdorimin e tyre, sjell mungesën e aksesibilitetit dhe efektivitetit të nevojshëm (*shih Aksoy kundër Turqisë, 18 dhjetor 1996, § 51, raporte dhe vendime 1996-VI*). Një ankues nuk mund të konsiderohet se ka dështuar të shterojë mjetet ligjore vendase nëse ai ose ajo mund të tregojë, duke paraqitur praktikën ligjore përkatëse vendase apo ndonjë të dhënë tjetër të përshtatshme, se një mjet ligjor në dispozicion të cilin ai ose ajo nuk e ka përdorur, ishte i detyruar të dështonte (*shih Kleyn dhe të tjerë kundër Holandës [GC] nr.39343/98, 39651/98, 43147/98 dhe 46664/99, § 156, GJEDNJ 2003-VI*).

97. Në rastin konkret, Gjykata vëren se në një datë të pacaktuar në vitin 1997 shoqëria ankuese kundërshtoi vendimin e Qeverisë të datës 22 gusht 1997. Më 17 shtator 1997 Gjykata e Apelit prishi vendimin për mospërputhje me të drejtën vendase. Më 28 tetor 1997 Qeveria caktoi të njëjtët administratorë me të njëjtat kushte që prishi Gjykata e Apelit. Shoqëria ankuese nuk apeloj kundër vendimit.

98. Për sa i përket kompetencave të administratorëve, Gjykata vëren se në vitin 1997 ankuesi individual kundërshtoi kushtetutshmërinë e nenit 7 të ligjit nr.2. Më 13 nëntor 1997 Gjykata Kushtetuese e shpalli këtë nen jokushtetues. Më 19 nëntor 1997, ligji nr.3 rifuti në mënyrë efektive të njëjtin formulim që ishte konstatuar jokushtetues, pas një shtese bërë ligjit për dispozitat kryesore kushtetuese i cili futi të drejtën e shtetit për të kontrolluar dhe administruar pronën e subjekteve private si ajo e shoqërisë ankuese.

99. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se nëse akuzat para Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Kushtetuese ishin, në parim, mjete ligjore për t'u shteruar, efektiviteti i tyre është bërë i pavlefshëm nga veprimet e autoriteteve. Prandaj, asnjë nga ankuesit nuk është kërkuar të bëjë recurs të mëtejshëm me një mjet ligjor, i cili, nëse do të rezultonte i suksesshëm, ka shumë të ngjarë që do të pengohej nga veprimet e autoriteteve.

100. Për më tepër, pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së re në vitin 1998, më 17 janar 1999 shoqëria ankuese u përpoq të kundërshtonte kushtetutshmërinë e ligjit për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë dhe ligjit për shitjen e pasurisë së personave juridikë jobankarë. Megjithatë, kundërshtimi i tij nuk mund të përmbushej, me sa duket për mungesë legjitimitimi sipas Kushtetutës së re (*shih paragrafin 27 më lart*). Gjykata, gjithashtu, përsërit se nëse më shumë se një mjet ligjor efektiv është në dispozicion, ankuesit i kërkohet të përdorë vetëm njërin prej tyre. Në fakt, kur përdoret një mjet ligjor, nuk kërkohet përdorimi i një mjeti tjetër ligjor i cili në thelb ka të njëjtin qëllim (*shih Micallef kundër Maltës [GC], nr.17056/06, § 58, GJEDNJ 2009-..., dhe Kozacioğlu kundër Turqisë, nr.2334/03, § 40, 31 korrik 2007*). Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vlerëson se ankuesve nuk u është kërkuar të shterojnë asnjë mjet tjetër ligjor në dispozicion siç pretendohet nga Qeveria.

101. Duke pasur parasysh vlerësimet e mësipërme, Gjykata vlerëson se ky kundërshtim duhet të rrëzohet.

### 3. Afati gjashtëmujor

102. Sipas nenit 35 § 1 të Konventës Gjykata “mund të merret me një çështje...brenda një periudhe gjashtëmujore nga data kur është marrë vendimi përfundimtar”. Neni 35 § 1 i referohet “vendimit përfundimtar” të marrë në procesin e shterimit të mjeteve ligjore vendase të cilat janë

“efektive dhe të mjaftueshme” për të zgjidhur ankimin e ankuesit. Megjithatë në rastet kur që në fillim është e qartë se asnjë mjet ligjor efektiv nuk është në dispozicion të ankuesit afati shtrihet nga data e ankimit ndaj ligjeve dhe masave ose nga data e marrjes dijeni të ligjit apo efektit të tij ose dëmit të ankuesit. Kur një ankues përdor një mjet ligjor ekzistues dhe vetëm më pas bëhet i ndërgjegjshëm për rrethanat që e bëjnë këtë mjet ligjor të paefektshëm, mund të jetë me vend për qëllime të nenit 35 § 1 që të merret si fillim i periudhës gjashtëmujore data kur për herë të parë ankuesi u bë ose duhej të bëhej i ndërgjegjshëm për këto rrethana (*shih Kolu kundër Finlandës (dec.)*, nr.56463/10, 3 maj 2011; *Varnava dhe të tjerë kundër Turqisë [GC]*, nr.16064/90, 16065/90, 16066/90, 16068/90, 16069/90, 16070/90, 16071/90, 16072/90 dhe 16073/90, § 157, GJEDNJ 2009-...; *Dennis dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar (dec.)*, nr.76573/01, 2 korrik 2002; dhe *Paul dhe Aubrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar (dec.)*, nr.46477/99, 4 qershor 2001).

103. Në rastin konkret Gjykata vëren se ankuesit përdorën në mënyrë të suksesshme mjetet ligjore vendase të paktën në dy raste. Efektiviteti i këtyre mjeteve ligjore është dëmtuar nga veprimet vijuese të Qeverisë (*shih paragrafët 97-98 më lart*). Në një rast të tretë, kërkesa kushtetuese e ankuesit në Gjykatën Kushtetuese është shpallur e papranueshme më 17 janar 1999 (*shih paragrafin 100 më lart*). Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se më së shumti më 17 janar 1999 ankuesit u bënë të ndërgjegjshëm se nuk kishte asnjë mjet ligjor efektiv në dispozicion të tyre në lidhje me ankimin sipas nenit 1 të protokollit nr.1. Pra, ato duhej të kishin paraqitur ankimin e tyre brenda gjashtë muajve nga data e mësipërme. Megjithatë, ankimi i tyre është depozituar më 2 janar 2005.

104. Gjykata më tej thekson se afati gjashtëmujor nuk zbatohet si i tillë në situatat e mëtejshme (*shih, për shembull, Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, nr.609/07, § 24, 20 korrik 2010).

Kjo ndodh sepse, nëse ka një situatë me shkelje të vazhdueshme, në të vërtetë afati fillon përsëri çdo ditë dhe vetëm kur ndërpritet situata, atëherë përfundon periudha përfundimtare prej gjashtë muajsh (*shih, Varnava dhe të tjerë, cituar më lart*, §§ 158-159).

105. Në praktikën e saj ligjore Gjykata ka vlerësuar se ka pasur “situata të vazhdueshme” që e paraqisnin çështjen brenda kompetencës së saj në lidhje me nenin 35 § 1 ku, *inter alia*, kishte raste të njëpasnjëshme përkatëse të cilat vazhdonin në kohën e paraqitjes së ankimit ose përfundonin më herët se gjashtë muaj para saj (*shih, për shembull, Vladimirova dhe të tjerë kundër Bullgarisë*, nr.42617/02, §§ 29-30, 26 shkurt 2009) ose ku një dispozitë ligjore shkaktonte gjendje të pandryshueshme të çështjeve në formën e një kufizimi të qëndrueshëm mbi të drejtën individuale të mbrojtur nga Konventa, siç është e drejta për të votuar ose kandiduar për zgjedhje (*shih Paksas kundër Lithuanisë [GC]*, nr.34932/04, § 83, 6 janar 2011, me referenca të mëtejshme).

106. Gjykata nuk përcakton nëse ankimi i ankuesve ka të bëjë me shkelje të vazhdueshme të Konventës nga shteti dhe për rrjedhojë është parashtruar në kohën e duhur ose nëse ka të bëjë me një ligj apo situatë që ka mbaruar më vonë se gjashtë muaj para datës së paraqitjes së ankimit të tyre.

107. Ankuesit ankohen sipas nenit 1 të protokollit nr.1 se legjislacioni në fuqi dhe veprimet e autoriteteve në lidhje me caktimin e administrimit të detyruar, kryerja e administrimit të detyruar, si dhe shitja dhe likuidimi i pasurive të tyre, rezultonte në privimin e së drejtës së pronës dhe në mohimin e së drejtës për akses në drejtësi.

108. Është e qartë nga faktet e çështjes se ndërhyrja e shtetit dhe ndërhyrja në gëzimin paqësor të ankuesve të pronës së tyre filloi, pas miratimit të ligjit për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë më 9 maj 1997. Masa legjislative të njëpasnjëshme hynë në fuqi, veçanërisht ligji për shitjen e pasurive të personave juridikë jobankarë i vitit 1998, ligji për rishpërndarjen e pasurive të personave juridikë jobankarë i vitit 1998, si dhe ligji për detyrimet debitore i vitit 1999.

109. Gjykata vëren se miratimi i ligjeve të mësipërme, i cili arriti kulmin në vitin 1999 synonte veçanërisht personat jobankarë siç është rasti konkret i shoqërisë ankuese. Ato përbënin ligje të menjëhershme, të vetme, që ndodhnin në momente të veçanta kohore (*shih Posti dhe Rahko kundër Finlandës nr.27824/95*, § 40, GJEDNJ 2002-VII; *Petkov dhe të tjerë kundër Bullgarisë (dec.)*, nr.77568/01, 178/02, dhe 505/02, 4 dhjetor 2007; dhe *Meltex LTD kundër Armenisë (dec.)*, nr.37780/02, 28 maj 2008). Ndryshimet e ligjeve të mësipërme, duke përfshirë vendimet e administratorëve dhe vendimet e Këshillit të Ministrave, ishin pasojë e tyre. Fakti që administrimi i detyruar vazhdon aktualisht, nuk shkakton gjendje të pandryshueshme të çështjeve, por është tregues i efekteve të qëndrueshme të masave dhe ligjeve të fundit legjislative.

110. Në këto rrethana veprimet e autoriteteve nuk përbëjnë shkelje të vazhdueshme të së drejtës së ankuesve. Në qoftë se, siç pretendojnë ankuesit, ato nuk janë bërë të ndërgjegjshëm për situatën deri

në miratimin e raportit parlamentar të vitit 2003, gjithsesi ato nuk kanë vepruar në përputhje me afatin e përcaktuar në nenin 35 § 1 të Konventës.

111. Prandaj Gjykata përfundon se ankimi duhet të rrëzohet meqenëse është jashtë afatit në përputhje me nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

**PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NJËZËRI:**

Deklaron ankimin të papranueshëm.

**ZËVENDEËS REGJISTRUES**  
**Fatoş Araci**

**KRYETAR**  
**Nicolas Bratza**

**SEKSIONI I KATËRT**  
**ÇËSHTJA ÇAUSH DRIZA KUNDËR SHQIPËRISË**  
(Ankimi nr.10810/05)

**VENDIM**  
**STRASBURG**  
15 mars 2011

Ky vendim do të marrë formë të prerë në rrethanat e përcaktuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.

Në çështjen Çausht Driza kundër Shqipërisë,  
Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Katërt), e mbledhur si Dhomë e përbërë nga:

Nicolas Bratza, president  
Sverre Erik Jebens  
Paivi Hirvela  
Ledi Bianku  
Zdravka Kaydjieva,  
Nebojsa Vucinic,  
Vincent A. de Gaetano, gjykatës,  
dhe Lawrence Early, regjistruer,  
Pas shqyrtimit me dyer të mbyllura më 22 shkurt 2011,  
Jep vendimin e mëposhtëm që është miratuar në atë datë:  
**PROCEDURA**

1. Çështja ka filluar mbi bazën e një kërkesë (nr.10 810/05) kundër Republikës së Shqipërisë, të paraqitur në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (Konventa) nga një shtetas shqiptar, z.Çausht Driza (kërkuesi) më 24 shkurt 2005.

2. Kërkuesi u përfaqësua fillimisht nga z. Z.Hajdarmataj dhe më pas nga z. A. Shehu, të dy avokatë që e ushtrojnë profesionin e tyre në Tiranë. Qeveria shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga agjentja e saj, znj. S.Meneri dhe më pas nga znj. E.Hajro.

3. Kërkuesi pretendoi se ka pasur një shkelje të nenit 6 §1 të Konventës në lidhje me padrejtësinë e procedimeve të brendshme dhe moszbatimin e një vendimi gjykate të formës së prerë. Ai u mbështet gjithashtu në nenin 13 të Konventës mbi mungesën e një mjete juridik efektiv në lidhje me moszbatimin e vendimit të gjykatës së formës së prerë në favor të tij dhe nenin 1 të protokollit nr.1 të Konventës në lidhje me një shkelje të të drejtës së tij për pronësinë.

4. Më 21 nëntor 2006, kryetari i seksionit të katërt të gjykatës të cilit iu caktua çështja, vendosi t'i jepte njoftim Qeverisë për kërkesën. Sipas dispozitave të nenit 29 § 1 të Konventës, u vendos shqyrtimi i themelit të kërkesës njëkohësisht me pranueshmërinë e saj.

5. Kërkuesi dhe Qeveria paraqitën veçmas vërejtje të mëtejshme me shkrim (rregulli 59§1).



## FAKTET

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

6. Kërkuesi ka lindur në 1943 dhe jeton në Fier, Shqipëri.
7. Më 20 maj 1947 autoritetet konfiskuan vilën njëkatëshe të të atit të kërkuesit dhe parcelën që i përket tokës së matur prej 360 metra katrorë, e cila ndodhej në qytetin e Fierit.
8. Më 6 qershor 1953 autoritetet ia transferuan S-së vilën e konfiskuar dhe parcelën e tokës.
9. Sipas ligjit të pronësisë të vitit 1993, në një datë të papërcaktuar, kërkuesi dhe nëntë vëllezërit e motrat e tij paraqitën një kërkesë pranë komisionit të Fierit për kthimin dhe kompensimin e pronave (komisioni), duke kërkuar kthimin e pronës së të atit të tyre. Më 27 tetor 1993 komisioni e rrëzoi kërkesën e tyre.
10. Kërkuesi paraqiti një apel pranë Gjykatës së Rrethit, Lushnjë (Gjykata e Rrethit), duke pretenduar se vendimi i komisionit ishte i paligjshëm.
11. Më 22 shkurt 2000, Gjykata e Rrethit njohu të drejtat e pronës së trashëguar të kërkuesit dhe të vëllezërve e motrave të tij mbi vilën dhe parcelën e tokës. Megjithatë, Gjykata e Rrethit çmoi se, për faktin që parcela e tokës ishte e zënë dhe vila njëkatëshe ishte transferuar S-së në mënyrë të ligjshme, ato nuk mund të rimerreshin nga kërkuesi dhe vëllezërit e motrat e tij. Gjykata u dha atyre kompensim në shumën prej 204,902 lekë shqiptare (lekë).
12. Kërkuesi dhe vëllezërit e motrat e tij apeluan, duke argumentuar se Gjykata e Rrethit i kishte vlerësuar provat në mënyrë të gabuar.
13. Më 30 qershor 2000 Gjykata e Apelit Vlorë (Gjykata e Apelit) i dha kërkuesit dhe vëllezërve e motrave të tij kompensim në natyrë për vlerën e parcelës së tokës, dhe jo kompensim monetar. Kërkuesi dhe vëllezërit e motrat e tij apeluan.
14. Më 18 qershor 2001 Gjykata e Lartë rrëzoi apelin, duke konstatuar se nuk përmbante arsye për paraqitje apeli, të parashikuar nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile. Kërkuesi dhe vëllezërit e motrat e tij paraqitën një apel kushtetues pranë Gjykatës Kushtetuese.
15. Më 10 qershor 2002 Gjykata Kushtetuese e mbledhur si panel prej tre gjykatësish, e shpalli apelin të papranueshëm.

16. Deri tani, vendimi i Gjykatës së Apelit nuk është zbatuar.

### II. LIGJI I BRENDSHËM PËRKATËS

#### A. Kushtetuta

17. Dispozitat përkatëse të Kushtetutës Shqiptare kanë përmbajtjen e mëposhtme:  
Neni 42 § 2  
“Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.  
Neni 142 § 3  
“Organet shtetërore janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.”  
Neni 131  
“Gjykata Kushtetuese vendos për:... (f) gjykimin përfundimtar të kërkesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

#### B. Ligji i pronësisë

18. Ligji i brendshëm përkatës në lidhje me kthimin dhe kompensimin e pronave në Shqipëri është përshkruar në vendimet Gjonbocari etj. kundër Shqipërisë, nr.10508/02, §§ 36-43, 23 tetor 2007, Driza kundër Shqipërisë, nr.33771/02, §§ 36-43, 13 nëntor 2007, Ramadhi etj. kundër Shqipërisë, nr.38222/02, §§ 23-30, 13 nëntor 2007.

19. Masa të reja dhe thelbësore legislative janë zbatuar duke ndryshuar ligjin kryesor të pronësisë së vitit 2004 që prej miratimit të këtyre vendimeve. Ndryshimet kryesore janë si më poshtë:

1. Ligji i pronësisë i vitit 2005 (ligji nr.9388 i 4 majit 2005)
20. Seksioni 3 shtyu deri më 31 dhjetor 2007, afatin për përfundimin e shqyrtimit të kërkesave për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronave të paluajtshme, me përjashtim të pagesës së shumës së kompensimit, afat kohor për të cilin u caktua viti 2015.
2. Ligji i pronësisë i vitit 2006 (ligji nr.9583 i 17 korrikut 2006)
21. Seksioni 13 themeloi Agjencinë për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave (Agjencia qendrore), e cila zëvendësoi Komitetin Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave (Komiteti

Shtetëror). Agjencia qendrore që drejtohej nga një drejtor, kishte selinë e saj në Tiranë dhe përbëhej nga dymbëdhjetë zyra agjencie rajonale.

22. Sipas seksionit 14, zyra e agjencisë rajonale ishte përgjegjëse për shqyrtimin fillestar të kërkesave për njohjen e të drejtave të pronës, në përgjigje të të cilave ajo vendosi për kthimin e pronës dhe/ose kompensimin në vend të tij. Seksioni 15 përcaktoi afatin kohor për paraqitjen e kërkesave mbi njohjen e të drejtave të pronësisë për datën 1 tetor 2007.

23. Seksioni 16 përcaktoi se një apel kundër një vendimi të zyrës së agjencisë rajonale mund të paraqitej pranë agjencisë qendrore. Vendimi i agjencisë qendrore mund të apelohej në Gjykatën e Rrethit, Tiranë, brenda tridhjetë ditësh nga njoftimi i tij.

24. Seksioni 21 shtyu deri në 31 qershor 2008, afatin për përfundimin e shqyrtimit të kërkesave mbi njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronave të paluajtshme, me përjashtim të pagesës së kompensimit.

25. Seksioni 22 parashikoi krijimin e Fondit të Kompensimit në Natyrë (FKN) paralelisht me Fondin e Kompensimit Financiar (FKF). Brenda gjashtëdhjetë ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit, Qeveria duhet të miratonte listën e pronave që duhet t'i shpërndahej FKN-së.

3. Ligji i pronësisë i vitit 2007 (ligji nr.9684 i 6 shkurtit 2007)

26. Seksioni 1 parashikoi se agjencia qendrore ishte përgjegjëse për shqyrtimin e kërkesave mbi kompensimin financiar dhe në natyrë. Agjencia qendrore ishte gjithashtu përgjegjëse për shqyrtimin e apeleve kundër vendimeve të zyrave të agjencisë rajonale.

27. Seksioni 2 ritheksoi se zyrat e agjencisë rajonale vazhdonin të ishin përgjegjëse për shqyrtimin fillestar të kërkesave për njohjen e të drejtave të pronësisë. Kërkuesi ose Avokatura e Shtetit, brenda tridhjetë ditësh, kishin të drejtën të apelonin kundër këtij vendimi pranë Agjencisë qendrore, e cila ishte organi më i lartë administrativ. Ky vendim administrativ i nënshtrohej rishikimit gjyqësor, në pajtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

4. Ligji i pronësisë i vitit 2008 (ligji nr.9898 i 10 prillit 2008)

28. Seksioni 1 shtyu deri më 31 dhjetor 2008, afatin kohor për paraqitjen e kërkesave mbi njohjen e të drejtave të pronësisë dhe kthimin e pronave nga zyra e agjencisë rajonale. Ai parashikoi gjithashtu mundësinë për një kërkues që t'i jepej një afat i ri kohor me anë të një vendimi gjyqësor.

29. Sipas seksionit 2, shqyrtimi i kërkesave për njohjen e të drejtave të pronësisë dhe kthimin e pronave do të përfundonte më 30 qershor 2009, me përjashtim të pagesës së shumës së kompensimit, afati kohor për të cilin ishte caktuar në vitin 2015.

30. Seksioni 3 shtyu deri më 31 dhjetor 2008, afatin kohor për shpërndarjen e pronave pranë FKN-së.

5. Ligji i pronësisë i vitit 2009 (ligji nr.10 095 i 12 marsit 2009)

31. Seksioni 2 parashikoi se përveç shumave të caktuara të fondeve buxhetore, alokimeve të siguruara në bazë të këtij ligji dhe donatorëve të tjerë, FKF do të përbëhej edhe nga të ardhurat e përfutuara nga ankandet e pronave shtetërore, të cilat nuk i ishin nënshtruar një vendimi Komisioni.

6. Ligji i pronësisë i vitit 2009 (ligji nr.10 207 i 23 dhjetorit 2009)

32. Seksioni 6 suprimoi zyrat e agjencisë rajonale. Ai deklaroi se arkivat e këtyre zyrave do të transferoheshin pranë agjencisë qendrore. Sipas seksionit 1, agjencia qendrore do të përfundonte shqyrtimin e kërkesave për njohjen e të drejtave të pronësisë dhe kthimin e pronave, të paraqitura pranë ish zyrave të agjencisë rajonale. Agjencia qendrore vazhdonte të shqyrtonte apelet e paraqitura pranë saj kundër vendimeve të ish zyrave të agjencisë rajonale.

33. Sipas seksionit 5, kërkuesi ose Avokatura e Shtetit kishin të drejtën e apelit kundër vendimit të agjencisë qendrore, pranë Gjykatës së Rrethit, Tiranë, brenda tridhjetë ditëve nga njoftimi i tij.

34. Seksioni 7 përcaktoi si afat për përfundimin e shqyrtimit të kërkesave mbi njohjen dhe kthimin e pronave, datën 31 dhjetor 2011.

7. Ligji i pronësisë i vitit 2010 ( ligji nr.10 308 i 22 korrikut 2010)

35. Ligji i pronësisë i vitit 2010 kryesisht paraqiste mundësinë e kërkimit të një rishikimi të vendimeve të zyrave të ish komisioneve/agjencisë rajonale.

36. Seksioni 4 shtyu deri më 31 dhjetor 2011, afatin kohor për shpërndarjen e pronave pranë FKN-së.

C. Vendimet e Këshillit të Ministrave (VKM)

37. Sipas ligjit të pronësisë, të ndryshuar, Qeveria ka miratuar një sërë aktesh nënligjore, me anë të vendimeve të Këshillit të Ministrave (VKM) të përshkruara më poshtë.

1. DCM mbi caktimet nga Fondi i Kompensimit Financiar (DCM nr.13 i 17 nëntorit 2005; DCM nr.758 i 16 nëntorit 2006; DCM nr.566 i 5 shtatorit 2007; DCM nr.1343 i 4 qershorit 2008 dhe DCM nr.487 i 6 majit 2009).

38. Sipas nenit 23 të ligjit të pronësisë të vitit 2004 që themeloi Fondin e Kompensimit Financiar, Qeveria miratoi vendimet e lartpërmendura midis periudhës 2005-2009, në lidhje me dhënien e kompensimit financiar ish-pronarëve.

39. Në 2005 kompensimi financiar ishte dhënë në lidhje me pretendimet për kompensim që lindnin në bazë të vendimeve të komisionit të Tiranës. Në 2006, kompensimi financiar u dha në lidhje me pretendimet për kompensim që lindnin në bazë të vendimeve të komisioneve të Tiranës dhe Kavajës. Në 2007, grupi i përfituesve u zgjerua për të përfshirë ish-pronarët të cilët kishin një vendim të komisionit të marrë në lidhje me qytetet për të cilat ishte miratuar dhe lëshuar një hartë për vlerësimin e pronave. Në 2008 dhe 2009, të gjithë ish-pronarët të cilët kishin të drejtën e kompensimit, pas një vendimi të komisionit/agjencisë rajonale, ishin të pranueshëm për të kërkuar kompensim financiar.

40. Sipas DCM-së së miratuar midis periudhës 2005-2008, një kërkuesi i kërkohej të paraqiste një kërkesë standarde për kompensim financiar pranë agjencisë qendrore në Tiranë, duke paraqitur, ndër të tjera, vendimin e komisionit/agjencisë rajonale që njihte të drejtën e tij për kompensim. Vetëm ata ish-pronarë të cilët nuk kishin marrë më parë kompensim, kishin të drejtë për kompensim financiar nga viti 2005 deri në 2008. DCM e vitit 2009 parashikonte se një ish-pronar kishte të drejtë për kompensim financiar, me kusht që të mos kishte përfituar nga: a) një kompensim i mëparshëm; b) rivendosje/kthim i pjesshëm i pronësisë; c) e drejta për refuzim fillestar; d) zbatimi i ligjit mbi shpërndarjen e tokës ( ligji nr.7501 i 19 korrikut 1991).

41. Kërkesat duhet të shqyrtoheshin në rend kronologjik mbi bazën e datës dhe numrit të vendimit të komisionit/agjencisë rajonale. Shuma e kompensimit financiar e cila duhet të llogaritej mbi bazën e hartave të vlerësimit të pronës, kufizohet në një sasi maksimale prej 200 metrash katrorë.

42. Paraqitja e një kërkesë përfshinte pagesën e një tarife procedurale. Ish-pronarët të cilët kishin qenë të pasuksesshëm në kërkesën e tyre për kompensim financiar në një vit paraardhës, mund të riparaqisnin kërkesën e tyre në vitin (et) e ardhshëm (e), pasi të kishin paguar tarifën procedurale.

43. Asnjë prej këtyre vendimeve nuk parashikonte dhënien e kompensimit për pretendimet e mbajtësit që lindnin në bazë të një vendimi gjykate të zbatueshëm të formës së prerë.

2. DCM-të mbi hartat e vlerësimit të pronave (DCM nr.555 e 29 shtatorit 2007; DCM nr.653 e 29 gushtit 2007 dhe DCM nr.139 e 13 shkurtit 2008; dhe DCM nr.1620 e 26 nëntorit 2008).

44. Në bazë të vendimeve të lartpërmendura, dy prej të cilave u miratuan në 2007 dhe dy në 2008, Qeveria miratoi dhe lëshoi harta për vlerësimin e pronave, siç renditen më sipër. Hartat përfshinin çmimin referues për metër katror në të gjithë vendin.

45. Vendimi i parë caktonte çmimin e tokës për rajonet e Beratit, Gjirokastrës, Vlorës dhe Dibërës; vendimi i dytë caktonte çmimin e tokës për rajonet e Lezhës, Dibërës, Korçës dhe Kukësit; vendimi i tretë caktonte çmimin e tokës për rajonet e Fierit, Elbasanit, Tiranës, Vlorës, Durrësit dhe Shkodrës. Vendimi i katërt përmbante një listë të përditësuar çmimesh për disa qytete.

3. DCM-të për kompensimin në natyrë të ish-pronarëve

46. Ligji i pronësisë i vitit 2006 parashikonte krijimin e FKN-së (shihni paragrafin 25 më lart). Qeveria ka miratuar DCM-të e mëposhtme për procedurat mbi shpërndarjen e pronave të mbuluar nga FKN-ja.

a) DCM nr.567 i 5 shtatorit 2007

47. Me vendimin nr.567 të 5 shtatorit 2007, Qeveria parashtrroi kriteret dhe procedurat për përcaktimin e pronave shtetërore të mbuluara nga FKN. Seksioni 1 rendit tipat e pronave, për shembull: a) pronat e paluajtshme publike që ndodhen në zonat turistike; b) pronat e Ministrisë së Mbrojtjes që nuk përdoren nga Forcat e Armatosura dhe që janë miratuar nga Presidenti i Republikës; c) toka bujqësore në dispozicion që i përket Ministrisë së Bujqësisë; d) pyjet, kullotat dhe livadhet; dhe e) pronat e institucioneve shtetërore që janë jashtë objektit të aktivitetit të synuar.

48. Institucionet vendore dhe qendrore shtetërore janë përgjegjëse për identifikimin dhe përpilimin e një liste të pronave të paluajtshme në pronësinë e tyre, që mund të shërbenin si kompensim në natyrë. Lista i është paraqitur Agjencisë dhe zyrave të saj rajonale, të cilat janë përgjegjëse për kontrollin e statusit ligjor të çdo prone. Agjencia i dorëzon Ministrit të Drejtësisë listën përfundimtare të pronave të paluajtshme për përfshirje në FKN. Qeveria duhet të miratojë listën dhe ta publikojë në Fletoren Zyrtare.

b) DCM nr.868 i 18 qershorit 2008

49. Me vendimin nr.868 të 18 qershorit 2008, Qeveria i alokoi FKN-së 17.335 hektarë tokë bujqësore. Agjencia është përgjegjëse për ta përdorur atë për kompensimin e pronarëve, në përputhje me kriteret e parashikuara me ligj.

c) DCM nr.1077 i 18 qershorit 2008

50. Me vendimin nr.1077 të 18 qershorit 2008, Qeveria i alokoi FKN-së 71.699.3 hektarë pyje dhe kullota. Agjencia do ta përdorë atë për kompensimin e pronarëve, në përputhje me kriteret e parashikuara me ligj.

d) DCM nr. 1232 i 18 qershorit 2008

51. Me vendimin nr.1232 të 18 qershorit 2008, Qeveria i alokoi FKN-së njëzet e nëntë objekte, kryesisht magazina, fabrika dhe godina zyresh. Agjencia është përgjegjëse për ta përdorur atë për kompensimin e pronarëve, në përputhje me kriteret e parashikuara me ligj.

e) DCM nr.1696 i 24 dhjetorit 2008

52. Me vendimin nr.1696 të 24 dhjetorit 2008, Qeveria i alokoi FKN-së tridhjetë e dy objekte, kryesisht magazina, godina zyresh dhe punishte. Agjencia është përgjegjëse për ta përdorur atë për kompensimin e pronarëve, në përputhje me kriteret e parashikuara me ligj.

D. Kodi i Procedurës Civile

53. Në lidhje me procedurën e apelit në Gjykatën e Lartë, Kodi i Procedurës Civile, për aq sa është i zbatueshëm, parashikon si më poshtë:

Neni 472

“Vendimet e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Rrethit mund të apelojnë në Gjykatën e Lartë, mbi bazën e arsyeve të mëposhtme: a) ligji nuk është zbatuar ose është zbatuar në mënyrë të gabuar; b) ka pasur shkelje të rënda të normave procedurale (sipas nenit 467 të Kodit); c) ka pasur shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit...”

Neni 480

“Një apel [në Gjykatën e Lartë] shpallet i papranueshëm nëse përmban arsye të ndryshme nga ato të parashikuara me ligj. Mospranimi i apeleve vendoset pas shqyrtimit me dyer të mbyllura”.

## LIGJI

### I. PRANUESHMËRIA E ANKESAVE

54. Kërkuesi u ankua në bazë të nenit 6 § 1 të Konventës se procedimet ishin të padrejta dhe se autoritetet nuk kishin zbatuar një vendim të formës së prerë në favorin e tij. Sipas nenit 13 të Konventës, ai u ankua se nuk kishte asnjë mjet juridik efektiv në lidhje me moszbatimin e një vendimi gjykate të formës së prerë. Ai gjithashtu paraqiti një ankesë sipas nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës.

A. Ankesat e nenit 6 § 1

55. Kërkuesi u ankua se procedimet gjyqësore kishin qenë të padrejta pasi gjykatat kishin vlerësuar provat në mënyrë të gabuar. Ai gjithashtu pretendoi se moszbatimi për një kohë të gjatë i vendimit të Gjykatës së Apelit të 30 qershorit 2000 kishte shkelur “të drejtën e tij për t’iu drejtuar gjykatës” sipas nenit 6 § 1, që për aq sa është i zbatueshëm, parashikon si më poshtë:

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile....çdokush ka të drejtën e një seance gjyqësore ....të drejtë nga [një] gjykatë....”

1. Padrejtësia e procedimeve

56. Qeveria çmoi se kjo ankesë ishte paraqitur jashtë afatit kohor prej gjashtë muajsh të parashikuar nga Konventa, ku vendimi i Gjykatës Kushtetuese i 10 qershorit 2002 është vendimi i fundit i brendshëm në lidhje me çështjen.

57. Gjykata vëren se kjo ankesë i ishte paraqitur më 24 shkurt 2005. Vendimi i formës së prerë për qëllimin e llogaritjes së afatit gjashtëmuajor ishte marrë më 10 qershor 2002. Gjykata vëren se kërkuesi nuk kishte respektuar rregullin për periudhën gjashtë mujore. Rezulton që kjo ankesë duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

2. Moszbatimi i vendimit të Gjykatës së Apelit i 30 qershorit 2000

a) Ankesa e paraqitur jashtë afatit

58. Qeveria çmoi se kjo ankesë ishte paraqitur jashtë afatit kohor prej gjashtë muajsh të parashikuar nga Konventa, ku vendimi i Gjykatës Kushtetuese i 10 qershorit 2002 është vendimi i fundit i brendshëm në lidhje me çështjen.

59. Kërkuesi parashtrroi se ankesa ishte depozituar brenda afatit kohor të parashikuar nga Konventa.

60. Gjykata vëren se moszbatimi nga ana e autoriteteve i vendimeve të formës së prerë krijon një situatë të përsëritur, në mënyrë që rregulli i periudhës gjashtë mujore të mos zbatohet (shihni Marini kundër Shqipërisë nr. 3738/02, § 95, GJEDNJ 2007-XIV (pjesë)). Rrjedhimisht, kundërshtimi i qeverisë duhet të rrëzohet.

b) Mosshterimi i mjeteve juridike të brendshme

61. Pa u mbështetur në një mjet të veçantë juridik, Qeveria pretendoi se kërkuesi nuk kishte shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike në dispozicion për moszbatimin e dyshuar të vendimit të 30 qershorit 2000.

62. Gjykata rithekson se rregulli i shterimit të mjeteve juridike të brendshme, i përmendur në Nenin 35 § 1 të Konventës, detyron kërkuesit të përdorin mjetet juridike që normalisht janë në dispozicion dhe të mjaftueshme në sistemin e brendshëm ligjor, për tu dhënë atyre mundësinë të marrin kompensimin për shkeljet e dyshuara. Ekzistenca e mjeteve ligjore duhet të jetë mjaftueshëm e sigurt, në praktikë dhe në teori, dhe në rast mungese, ata nuk do të kenë aksesin dhe efektivitetin e nevojshëm; i takon Shtetit përgjegjës të verifikojë që këto kushte të ndryshme të përmbushen (shihni 46113/99, 3843/02, 13751/02, 13466/03, 10200/04, 14163/04, 19993/04 dhe 21819/04, §§ 69-70, GJEDNJ 2010-...).

63. Në çështjen në fjalë, Gjykata vëren se Qeveria nuk mbështetej haptazi në ndonjë mjet juridik të caktuar që duhet të përdorej nga kërkuesi. Megjithatë, Gjykata çmon se çështja e ekzistencës së mjeteve juridike efektive në lidhje me moszbatimin e vendimit të 30 qershorit 2000, dhe në veçanti efektiviteti i mjeteve juridike të ofruara nga Ligji i Pronësisë, i paraqitur pas miratimit të këtij vendimi gjykate në çështjen Driza, të cituar më lart, duhet t'i bashkohet themelit dhe të shqyrtohet në lidhje me ankesën e kërkuesit sipas Nenit 13 (shihni paragrafët 72-83 më poshtë).

64. Gjykata çmon se kjo ankesë nuk është haptazi e pabazuar brenda kuptimit të Nenit 35 § 3 të Konventës. Meqë nuk është e papranueshme për arsye të tjera, ankesa duhet të shpallet e pranueshme.

B. Neni 13 i Konventës

65. Kërkuesi u ankua sipas Nenit 13 të Konventës se nuk kishte asnjë mjet juridik efektiv për të zbatuar vendimin e formës së prerë të Gjykatës së Apelit të 30 qershorit 2000 që jepte kompensim në natyrë.

Neni 13 i Konventës parashikon si më poshtë:

“Çdokush, të drejtat dhe liritë e të cilit të përcaktuara në Konventë, janë shkelur, ka një mjet juridik efektiv para një autoriteti kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në një funksion zyrtar.”

66. Gjykata çmon se kjo kërkesë nuk është haptazi e pabazuar brenda kuptimit të Nenit 35 § 3 të Konventës. Ajo konstaton më tej se ankesa nuk është e papranueshme për arsye të tjera. Rrjedhimisht, duhet të shpallet e pranueshme.

Neni 1 i Protokollit Nr. 1 të Konventës

67. Kërkuesi pretendoi se moszbatimi i vendimit të Gjykatës së Apelit i 30 qershorit 2000 përfshinte një shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, i cili parashikon:

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të zotërimeve të tij. Askush nuk privohet nga zotërimet e tij, përveç kur kjo është në interesin publik, në bazë të kushteve të parashikuara me ligj dhe nga parimet e përgjithshme të të drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mësipërme në asnjë mënyrë nuk cenojnë të drejtën e një Shteti për të zbatuar këto ligje, siç i çmon të nevojshme, për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagesën e taksave ose kontributeve ose gjobave të tjera.”

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të zotërimeve të tij. Askush nuk privohet nga zotërimet e tij, përveç kur kjo është në interesin publik, në bazë të kushteve të parashikuara me ligj dhe nga parimet e përgjithshme të të drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mësipërme në asnjë mënyrë nuk cenojnë të drejtën e një shteti për të zbatuar këto ligje, siç i çmon të nevojshme, për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me

interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagesën e taksave ose kontributeve ose gjobave të tjera.”

68. Qeveria pretendoi se kjo ankesë ishte paraqitur jashtë afatit kohor.

69. Kërkuesi parashtrroi se ankesa ishte depozituar brenda afatit kohor të parashikuar nga Konventa.

70. Gjykata i referohet përfundimeve të saj në paragrafin 60 më lart. Nga përfundimet rezulton se rregulli i periudhës gjashtëmujore nuk zbatohet për ankesën në fjalë. Rrjedhimisht, kundërshtimi i Qeverisë duhet të rrëzohet.

71. Gjykata çmon më tej se ankesa sipas këtij kreu nuk është haptazi e pabazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Duke qenë se nuk është përcaktuar asnjë arsye tjetër për shpalljen e kësaj pjese të kërkesës të papranueshme, Gjykata e shpall këtë ankesë të pranueshme.

## II. SHKELJA E DYSHUAR E NENIT 13 TË KONVENTËS

72. Qeveria parashtrroi se kërkuesi mund të kishte pasur rekurs ndaj mjeteve juridike në dispozicion për të kërkuar kompensim në natyrë për të cilin ai kishte të drejtë.

73. Gjykata rikujton se në vendimin e saj në çështjen *Driza*, ajo konstatoi si më poshtë:

“118. Gjykata vëren se ligji i pronësisë i vitit 1993 (që u shfuqizua nga ligji i pronësisë i vitit 2004, i cili për rrjedhojë ishte ndryshuar nga ligji i pronësisë i vitit 2006) parashikonte forma të ndryshme kompensimi kur prona fillestare nuk mund t'i kthehej ish-pronarit (...). Ligji i pronësisë i vitit 1993 ia la përcaktimin e formës së përshtatshme të kompensimit Këshillit të Ministrave, i cili duhet të përcaktonte rregulla dhe metoda të hollësishme të zbatueshme për sigurimin e kompensimit. Sipas përfundimeve të Gjykatës së Lartë në vendimin e saj të 7 dhjetorit 2000, organet kompetente për trajtimin e çështjeve të kompensimit ende nuk ishin krijuar (...). Pavarësisht nga hyrja në fuqi e ligjit të pronësisë së vitit 2004, situata nuk kishte ndryshuar. Vetëm në 28 prill 2005, Parlamenti miratoi një ligj që përcaktonte metodologjinë mbi vlerësimin e pronave për qëllime kompensimi. Seksioni 5 i atij ligji ia la detyrën e zbatimit të kësaj metodologjie Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave, i cili duhet të kishte përgatitur planet përkatëse të trojeve për të lejuar vlerësimin e pronave. Megjithatë, deri tani këto plane nuk janë miratuar.

119. Rrjedhimisht, Gjykata çmon se, ndërsa nuk ishin krijuar organet përkatëse për trajtimin e çështjeve të kompensimit ose miratimit të planeve të trojeve për vlerësimin e pasurive, Qeveria nuk kishte hartuar një procedurë të përshtatshme në lidhje me pretendimet për kompensim. Për më tepër, nuk ekziston mundësia që Qeveria të vërë në funksionim një sistem të tillë menjëherë ose brenda një periudhe kohe mjaftueshëm të shkurtër, për të mundësuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes në lidhje me përcaktimin e të drejtave të kërkuesit.”

74. Gjykata vëren se që prej datës së miratimit të vendimit në çështjen *Driza*, Qeveria kishte miratuar dispozita të reja ligjore në lidhje me dhënien e kompensimit financiar, miratimin e hartave të vlerësimit të pronave dhe krijimin e FKN-së (*shihni seksionin “Ligji përkatës i brendshëm” më lart*). Rrjedhimisht, gjykata duhet të përcaktojë nëse masat e marra përbëjnë një mjet juridik efektiv brenda kuptimit të nenit 13 të Konventës.

75. Gjykata rithekson se neni 13 i Konventës parashikon shprehimisht detyrimin e shteteve, të parashikuar në nenin 1 të Konventës, për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në radhë të parë brenda sistemit të tyre ligjor. Kështu, ajo kërkon që shtetet të ofrojnë një mjet juridik të brendshëm për të trajtuar thelbin e një “kërkese të argumentueshme” sipas Konventës dhe për të dhënë një kompensim të përshtatshëm (*Burdov kundër Ruisë (nr.2), nr.33509/04, § 96, GJEDNJ 2009...; dhe Yuriy Nikolayevich Ivanov kundër Ukrainës, nr.40450/04, § 63, GJEDNJ 2009....(pjesë)*).

76. Objekti i detyrimeve të Shteteve Kontraktuese sipas nenit 13 të Konventës ndryshon në varësi të natyrës së ankesës së kërkuesit; “efektiviteti” i një “mjeti ligjor” brenda kuptimit të kësaj dispozite nuk varet nga siguria e një rezultati të favorshëm për kërkuesin. Njëkohësisht, mjeti juridik i kërkuar nga neni 13 duhet të jetë “efektiv” në praktikë, si dhe në ligjin në kuptimin ose të parandalimit të shkeljes së dyshuar ose vazhdimin të saj, ose të sigurimit të kompensimit të mjaftueshëm për çdo shkelje që tashmë ka ndodhur (*shihni Burdov (nr. 2), e cituar më lart, § 97; dhe Yuriy Nikolayevich Ivanov, cituar më lart, § 64*).

77. Gjykata ka vërejtur zhvillimet e rëndësishme të brendshme ligjore që kanë ndodhur në Shqipëri në vijim të vendimeve të kësaj Gjykate, në çështjet *Driza*, dhe *Ramadhi etj*, cituar më lart. Megjithatë, çështja që do të trajtohet nga Gjykata është nëse ekziston një mjet i brendshëm ligjor në lidhje me zbatimin e vendimeve të formës së prerë të gjykatave që japin kompensim në natyrë.

78. Fillimisht Gjykata vëren se më 17 korrik 2006, ligji i pronësisë parashikonte krijimin e FKN-së. Ai vëren gjithashtu se vetëm në 5 shtator 2007, Qeveria miratoi një vendim për procedurat mbi shpërndarjen e pronave për FKN-në. Qeveria i caktoi FKN-së prona, kryesisht toka bujqësore, pyje dhe kullota, dhe godina të ndryshme gjatë të gjithë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2008.

79. Gjykata vëren më tej se në të paktën dy raste, afati kohor për shpërndarjen e pronave pranë FKN-së ishte shtyrë ndërsa afati kohor aktual ishte caktuar në datën 31 dhjetor 2011. Qeveria nuk paraqiti asnjë informacion rreth progresit të shpërndarjes së pronave pranë FKN-së gjatë vitit 2009 dhe 2010.

80. Së dyti, asnjë informacion nuk ishte paraqitur në vëmendje të Gjykatës rreth miratimit të ndonjë procedure që një kërkues, si për shembull kërkuesi në fjalë, mund të përdorte për të mbrojtur të drejtën e tij për kompensim në natyrë, të dhënë në bazë të një vendimi gjykate të formës së prerë.

81. Së treti, në Gjykatës nuk u paraqitën dokumente që tregonin se Agjencia në fakt u kishte dhënë kompensim në natyrë kërkuesve, si për shembull kërkuesi në fjalë, të cilët kanë një pretendim të zbatueshëm kompensimi në bazë të një vendimi gjykate të formës së prerë. Për më tepër, Gjykata nuk mund të identifikojë ndonjë masë tjetër që është miratuar, me synim garantimin e zbatimit të një vendimi gjykate të formës së prerë që i jep kompensim në natyrë një kërkuesi në vend të kthimit të pronës fillestare.

82. Sa më sipër, Gjykata çmon se kërkuesi nuk kishte një mjet juridik efektiv që t'i jepte atij mundësinë e garantimit të zbatimit të së drejtës së tij për kompensim, të njohur në bazë të një vendimi gjykate të formës së prerë.

83. Kështu, ka pasur një shkelje të nenit 13 të Konventës. Për rrjedhojë, Gjykata rrëzon kundërshtimin e Qeverisë se kërkuesi nuk shteroi mjetet e brendshme juridike efektive.

### III. SHKELJA E DYSHUAR E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

84. Qeveria parashtrroi se kërkuesi nuk kishte qenë asnjëherë i interesuar për marrjen e kompensimit në natyrë, të dhënë në bazë të vendimit të Gjykatës së Apelit të 30 qershorit 2000. Sipas pikëpamjes së tyre, kërkuesi këmbënguli për rikthimin e pronës fillestare.

85. Kërkuesi deklaroi se deri tani, vendimi i 30 qershorit 2000 që njihte të drejtën e tij për kompensim, nuk ishte zbatuar.

86. Parimet e përgjithshme sipas nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me moszbatimin e vendimeve të gjykatës të formës së prerë parashtrohen në Gjyli kundër Shqipërisë (nr.32907/07, §§ 43-44, 29 shtator 2009) dhe Beshiri etj. kundër Shqipërisë ( nr.7352/03, §§ 60-61, 22 gusht 2006).

87. Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës së Apelit i 30 qershorit 2000, mori formë të prerë më 10 qershor 2002. Deri tani, autoritetet nuk kanë marrë masa për zbatimin e këtij vendimi në favor të kërkuesit.

88. Gjykata rikujton se tashmë ka konstatuar një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për shkak të moszbatimit të një vendimi gjykate të formës së prerë në çështjet e Beshiri etj., cituar më lart, §§ 62-66; Driza cituar më lart, §§ 87-94 dhe Vrioni etj. kundër Shqipërisë dhe Italisë (nr. 35720/04 dhe 42832/06, §§ 54-61, 29 shtator 2009). Ajo nuk sheh asnjë arsye për të devijuar nga këto përfundime në këtë çështje.

89. Kështu, gjykata arrin përfundimin se ka pasur një shkelje të të drejtave të kërkuesit për aksesin për t'iu drejtuar një gjykate sipas nenit 6 § 1 të Konventës.

### IV. SHKELJA E DYSHUAR E NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1 TË KONVENTËS

90. Qeveria parashtrroi se interesi i kërkuesit qëndronte në kthimin e pronës fillestare në vend të dhënies së kompensimit në natyrë.

91. Gjykata rithekson se një “pretendim” mund të përbëjë një “zotërim” brenda kuptimit të nenit 1 të protokollit nr.1, nëse ai konstatohet i zbatueshëm në nivel të mjaftueshëm (shihni Rafineritë Greke Stran dhe Stratis Andreadis kundër Greqisë, vendim i 9 dhjetorit 1994, Seria A nr.301-B, fq 84, § 59).

92. Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës së Apelit i 30 qershorit 2000 i siguroi kërkuesit një pretendim të zbatueshëm për kompensim në natyrë në vend të kthimit të pronës. Rrjedhimisht, kërkuesi kishte “zotërim” brenda kuptimit të nenit 1 të protokollit nr.1.

93. Gjykata rikujton praktikën e saj gjyqësore, me qëllim që pamundësia e një kërkuesi për të siguruar ekzekutimin e një vendimi gjykate të formës së prerë në favorin e tij ose të saj, të përbëjë një ndërhyrje në të drejtën për gëzimin paqësor të zotërimeve, siç përcaktohet në fjalinë e parë të paragrafit të parë të nenit 1 të protokollit nr.1 (shihni, midis autoriteteve të tjera, Burdov kundër Ruisë, nr. 59498/00, § 40, GJEDNJ 2002-III).

94. Gjykata vëren se tashmë ka konstatuar një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për shkak të moszbatimit nga ana e autoriteteve të një vendimi gjykate të formës së prerë që jep kompensim në natyrë (shihni paragrafët 86-89 më lart).

95. Për më tepër, Gjykata tashmë ka konstatuar një shkelje të të drejtave të pronësisë së kërkuesit për shkak të mosdhënies nga ana e autoriteteve të kompensimit që lind në bazë të një vendimi gjykate të formës së prerë në çështjen Beshiri etj. (cituar më lart, § § 95-103); Driza (cituar më lart, §§ 101-109); dhe Vrioni etj. (cituar më lart §§ 71-77). Gjykata nuk sheh asnjë arsye për të arritur një përfundim të ndryshëm në rrethanat e kësaj çështjeje.

96. Rrjedhimisht, ka pasur një shkelje të nenit 1 të Protokollit nr.1 të Konventës.

#### V. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

97. Neni 41 i Konventës parashikon si më poshtë:

“Nëse Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose protokolleve të saj, dhe nëse ligji i brendshëm i Palës së Lartë Kontraktuese të interesuar lejon që të bëhet vetëm kompensimi i pjesshëm, nëse është e nevojshme, Gjykata do t’i japë kompensim të drejtë palës së dëmtuar.”

98. Kërkuesi, duke u mbështetur në një raport eksperti, kërkoi 451,365 euro (euro) në lidhje me dëmin monetar. Ai nuk ngriti pretendime për dëmin jomonetar, as për kostot dhe shpenzimet.

99. Gjykata kundërshtoi pretendimet e kërkuesit, të cilat janë paraqitur jashtë afatit.

100. Gjykata vëren se pretendimi i kërkuesit për kompensim të drejtë në fakt ishte paraqitur më 8 korrik 2009, më shumë se dy vjet pas mbarimit të afatit fillestar më 23 prill 2007. Gjykata vëren më tej se kërkuesi nuk kishte paraqitur asnjë arsye që të justifikonte mospërbushjen nga ana e tij të kërkesave të rregullit 60 § 2 të rregullave të Gjykatës. Në këto rrethana, Gjykata çmon se pretendimi i tij duhet të rrëzohet.

101. Gjykata vëren se kërkuesit i mbetet e drejta për dhënien e një kompensimi në natyrë sipas vendimit të Gjykatës së Apelit në favor të tij (*shihni Cooperativa Agricola Slobozia –Hanesei kundër Moldavisë, nr.39745/02, § 32, 3 prill 2007*) dhe se autoriteteve u kërkohet të marrin hapat e nevojshëm për të garantuar zbatimin e atij vendimi.

#### PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, UNANIMISHT:

1. Vendos t’i bashkojë themelit të ankesës sipas nenit 13 të Konventës, kundërshtimin e Qeverisë në lidhje me shterimin e mjeteve juridike të brendshme mbi moszbatimin e vendimit të Gjykatës së Apelit të 30 qershorit 2000.

2. Shpall ankesën në lidhje me padrejtësinë e procedimeve sipas nenit 6 §1 të papranueshme dhe pjesën tjetër të kërkesës të pranueshme.

3. Çmon se ka pasur një shkelje të nenit 13 të Konventës, dhe për rrjedhojë, rrëzon kundërshtimin e Qeverisë për shterimin e mjeteve juridike të brendshme;

4. Çmon se ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me moszbatimin e vendimit të Gjykatës së Apelit të 30 qershorit 2000;

5. Çmon se ka pasur një shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës për shkak të moszbatimit të vendimit të Gjykatës së Apelit të 30 qershorit 2000;

6. Rrëzon pretendimin e kërkuesit për kompensim të drejtë.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 15 mars 2011, sipas rregullit 77 § 2 dhe 3 të Rregullave të Gjykatës.

**Lawrence Early**  
Regjistruer

**Nicolas Bratza**  
President



SEKSIONI I KATËRT  
ÇËSHTJA VRIONI DHE TË TJERËT V.KUNDËR SHQIPËRISË  
(Numri i aplikimit 35720/04 dhe 42832/06)

VENDIM  
(Kompensim i drejtë)  
STRASBURG  
7 dhjetor 2010

*Ky vendim merr formën e prerë nën rrethanat e paraqitura në nenin 44§2 të Konventës. Ai mund të bëhet subjekt i një rishqyrtimi për qëllime editoriale.*

Në çështjen Vrioni dhe të tjerët v.Shqipërisë  
Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), e mbledhur si një dhomë e përbërë nga:

Nicolas Bratza, President  
Lech Garlicki  
Liljana Mijovic  
David Thor Bjorgvinsson  
Ledi Bianku  
Mihai Poalelungi  
Vincent Anthony de Gaetano, gjykatës  
dhe Lawrence Early, Regjistrari i Seksionit  
Pasi diskutoi në privatësi më 16 nëntor  
Lëshon vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në këtë datë:  
PROCEDURA

1. Çështja e ka filluesën me dy aplikime (nr.35720/04 dhe 42832/06) kundër Republikave të Shqipërisë dhe Italisë të paraqitura në Gjykatë në bazë të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore (të Konventës) nga dy shtetas shqiptarë, z. Shahin Vrioni dhe z. Oliver Vrioni dhe dy shtetas italianë, z. Dario La Francesca dhe z. Gherardo La Francesca. Aplikuesit u ankuan se ka pasur thyerje të nenit 6 § 1 të Konventës, neni 1 të protokollit nr.1 ndaj Konventës dhe nenit 13 në lidhje me nenin 1 të protokollit nr.1.

2. Aplikuesit u përfaqësuan nga znj. L.Sula, avokate që e ushtron profesionin e saj në Tiranë. Qeveria shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga agjenti i saj, znj. E. Hajro.

3. Në vendimin e marrë më datë 29 shtator 2009 (vendimi themelor), Gjykata njoftoi se ka pasur një thyerje të nenit 6§1 të Konventës dhe të nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës në llogari të autoriteteve shqiptare, të cilat nuk zbatuan një vendim të formës së prerë të gjykatës i cili i përcaktonte kompensim aplikantëve në vend të rikthimit të pronës. Më tej, Gjykata hodhi dritë mbi një shkelje të nenit 13 në lidhje me nenin 1 të protokollit nr.1 (*Vrioni dhe të tjerët v. Shqipërisë dhe Italisë*, nr.35720/04 dhe 42832/06, §§ 48-85, 29 shtator 2009). Gjykata i kundërshtoi ankesat e aplikuesve kundër Italisë si të papajtueshme, *ratione personae*.

4. Në bazë të nenit 41 të Konventës aplikuesit kërkuan shuma të ndryshme për t'u kompensuar.

5. Duke qenë se kërkesa për aplikimin e nenit 41 të Konventës nuk ishte gati për vendim, Gjykata e arkivoi të gjithë çështjen dhe ftoi Qeverinë dhe aplikuesit të parashtronjë, brenda tre muajve nga data kur vendimi është bërë i formës së prerë sipas nenit 44§2 të Konventës, vërejtjet e tyre me shkrim mbi çështjen dhe në veçanti, të njoftojnë Gjykatën për çdo lloj marrëveshje që mund të arrihet midis tyre (*ibid.*, §§ 88-91 dhe pika 9 e parashikimeve operative).

6. Si aplikuesit edhe Qeveria i arkivuan vërejtjet brenda afateve që iu ishin përcaktuar. Nuk u gjet asnjë fakt mbi të cilin mund të sigurohej një marrëveshje miqësore.

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

7. Më 18 mars 1999 dhe 14 dhjetor 1999 Komisioni për Rikthimin dhe Kompensimin e Pronave në Tiranë (Komisioni) njohu kërkesën e aplikantëve për dy sipërfaqe tokash, respektivisht 1,100 m<sup>2</sup> dhe 537 m<sup>2</sup>. Komisioni shpjegoi se ishte e pamundur që pronarëve t'iu kthehej trualli i tyre origjinal. Ai

vendosi t'iu siguronte aplikuesve një truall të lirë me përmasat 1,456 m<sup>2</sup>, i cili ndodhej brenda hapësirave të zëna nga Ambasada Italiane, dhe iu kërkoi autoriteteve të paguanin për të kompensuar një truall me përmasat 181 m<sup>2</sup>. Për më tepër, ai urdhëroi që pronësia e aplikantëve mbi këtë tokë të hynte në Regjistrin e Pronësisë së Tiranës.

8. Aplikantët ndërmorën një veprim civil duke pasur parasysh pamundësinë e tyre për të rimarr truallin prej 1,456 m<sup>2</sup>. Bazuar në vendimin e Gjykatës së Apelit, në datën 29 tetor 2002, ishte vendosur që aplikuesit duhej të merrnin kompensim në vend të pronës së tyre origjinale në një nga format e përcaktuara nga ligji në përputhje me truallin me përmasat 1,456 m<sup>2</sup>. Gjykata e Apelit pohoi se meqë trualli ishte pjesë integrale e planeve të Ambasadës Italiane, ai nuk mund të konsiderohej vakant dhe për pasojë nuk mund të shërbente për kompensim për aplikantët. Ky vendim u shqyrtua nga Gjykata e Lartë më 15 qershor 2004. Për pasojë, aplikantët do të merrnin kompensim sipas aktit të pronës për një total toke prej 1,637 m<sup>2</sup> (*shiko §§ 24-25 të vendimit themelor*).

9. Detaje të mëtejshme shpjegohen në vendimin themelor.

## II. LIGJI VENDOR PËRKATËS

A. Akti mbi çmimin e tokës që kompensohet (ligji nr.7832 i datës 16 qershor 1996 - ligji për çmimin e truallit që kompensohet), “Akti i vitit 1994”

10. Akti i vitit 1994 përmbante kriteret që do të përdreshin për përcaktimin e kompensimit financiar që do t'iu jepej pronarëve të mëparshëm. Sipas aktit të vitit 1994 Tirana do të ndahej në tre zona A, B dhe C. Çmimi i referencës për pronën e pozicionuar në zonën A u përcaktua me 1,600 lekë shqiptare (e gjitha) për metër katror.

B. Vendimet e Këshillit të Ministrave (VKM) mbi hartat e vlerësimit të pronave (vendimi i Këshillit të Ministrave nr.555 i datës 29 shtator 2007; vendimi i Këshillit të Ministrave nr.139 të datës 13 shkurt 2008 dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr.1620 të datës 26 nëntor 2008)

11. Në bazë të tre vendimeve, dy prej të cilëve u miratuan në 1997-ën dhe një në 2008-ën, Qeveria aprovoi dhe deklaroi hartat e vlerësimit të pronës siç janë listuar më sipër. Hartat, të cilat do të përdreshin në përcaktimin e shpërblimit të kompensimit financiar nga autoritetet përkatëse, përfshinin çmimin e referencës për metër katror në të gjithë vendin.

12. Vendimi i parë përcaktoi çmimin e tokës në rajonin e Beratit, Gjirokastrës, Vlorës dhe Dibrës; vendimi i dytë përcaktoi çmimin e tokës për rajonin e Lezhës, Dibrës, Korçës dhe Kukësit; vendimi i tretë përcaktoi çmimin e tokës për rajonin e Fierit, Elbasanit, Tiranës, Vlorës, Durrësit dhe Shkodrës. Vendimi i katërt përmbante një listë çmimesh të rishikuara për disa qytete të caktuara. Sipas atij vendimi, çmimi i referencës për metër katror për zonën në të cilën pozicionohej prona e aplikuesit u vlerësua me 180,000 e gjitha.

## LIGJI

13. Neni 41 i Konventës pohon:

“Nëse Gjykata zbulon se ka pasur shkelje të Konventës ose të protokolleve, dhe nëse ligji i brendshëm i Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një shlyerje e pjesshme, po të jetë e nevojshme, Gjykata do të sigurojë kompensim për palën e dëmtuar”.

### A. Dëmi

#### 1. Parashtrimet e palëve

##### a. Aplikuesit

14. Aplikantët vlerësuan me 3,916,200 euro dëmin monetar dhe me 200,000 euro dëmin jomonetar.

15. Aplikantët pohuan se kompensimi duhej të përcaktohej në bazë të totalit të truallit prej 1,637 m<sup>2</sup> duke përfshirë truallin prej 182 m<sup>2</sup>. Ata pohuan se e drejta e tyre për kompensimin e të gjithë kësaj sipërfaqe toke iu ishte njohur nga vendimet e Komisionit të vitit 1996 dhe 1999.

16. Aplikantët dëshironin që dëmi monetar të llogaritej në bazë të vlerës së tregut të tokës në fjalë. Ata nuk binin dakord me propozimin e Qeverisë për t'i aplikuar kriteret e cituara në këtë vendim Gjykate, në çështjen e *Guiso-Gallisay v. Italisë* (kompensim i drejtë) (vendimi nr.58858/00, §§ 103-105, 22 dhjetor 2009), duke argumentuar se atyre nuk iu ishte shpronësuar asnjëherë toka ashtu siç kishte ndodhur me aplikuesit në çështjen *Guiso-Gallisay kundër Italisë*, nr.58858/00, §§ 78-97, 8 dhjetor 2005.

17. Gjatë negociatave me Qeverinë, aplikuesit kishin parashtruar tre metoda për llogaritjen e dëmit monetar. Në fund, ata propozuan se çmimi i referencës për metër katror për llogaritjen e dëmit monetar duhej të ishte 1,500 euro. Sipas tyre, ky çmim korrespondonte me çmimin e referencës për metër katror në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1620 të datës 26 nëntor 2008. Duke u bazuar mbi këtë vendim të Këshillit të Ministrave, aplikuesit kontestuan propozimin e Qeverisë për të aplikuar çmimin e referencës prej 1,600 e gjitha, për metër katror, ashtu siç ishte përcaktuar në aktin e 1994-ës (*shiko paragrafin 10 më sipër*).

18. Më tej, aplikantët kërkuan që humbja e përfitimeve t'i shtohet shumës së dëmit monetar. Ata shpjeguan se pozicioni i pronës së tyre do të tërhiqte investitorët e pronave të ndërtonin godina të larta, ashtu siç kishte ndodhur me një truall ngjitur me truallin e tyre. Si rezultat i kësaj, ata do të kishin përfutur përfitime të larta. Aplikuesit parashtruan një kontratë investimi, të cilën e kishin përfunduar më 17 maj 2010 me një kompani ndërtimi. Për më tepër, humbja e përfitimeve duhej të përfshinte qiranë që ata do të kishin përfutur duke e lëshuar tokën me qira. Së fundmi, aplikuesit kërkuan që të aplikohet një shkallë interesi duke filluar nga viti 1996, vit në të cilin ata kishin institucionalizuar procedurat ligjore.

19. Si përfundim, vlerësimet e aplikuesve për dëmin monetar ishin si më poshtë:

Një truall me përmasat 1,456 m <sup>2</sup> x 1,500 euro m <sup>2</sup>	2,184,000 euro
Vlera e qerasë për periudhën 1 qershor 1996 - 1 qershor 2006	535,500 euro
Vlera e qerasë për periudhën 1 qershor 2006 - 1 qershor 2010	274,200 euro
Një truall me përmasat 181 m <sup>2</sup>	271,500 euro
Interesi bankar për qiranë e vlerësuar për periudhën 1 qershor 2006 - 1 qershor 2010-651,000 euro	

**Totali 3,916,200 euro**

b. Qeveria

20. Qeveria pohoi se aplikuesve iu ishte dhënë e drejta për kompensim për një truall me përmasat 1,456 m<sup>2</sup>, ashtu siç ishte vendosur nga gjykatat kombëtare. Ata e kundërshtuan kërkesën e aplikuesve për t'u kompensuar edhe për truallin me përmasat 181 m<sup>2</sup>, i cili sipas tyre, nuk kishte qenë objekti i kontrollit të Gjykatës në vendimin e saj fillestar.

21. Qeveria përpunoi dy metoda për llogaritjen e dëmit monetar. Sipas metodës së parë të përlllogaritjes, ata propozuan përdorimin e çmimit të referencës për metër katror, siç ishte miratuar nga vendimi i Këshillit të Ministrave për hartat e vlerësimit të pronës (*shiko paragrafët 11 dhe 12 më sipër*).

22. Metoda e dytë e përlllogaritjes, të cilën ata e përkrahnin më shumë, bazohej mbi këtë vendim të Gjykatës në çështjen *Driza v. Shqipërisë*, nr.33771/02, § 137, ECHR 2007-XII (ekstraktet), të cilat i referoheshin “çmimeve ... të tregut të pronave në kohën e vendimeve të rëndësishme (vendore)”. Më tej Qeveria u mbështet mbi principin e kohëve të fundit, të miratuar nga Dhoma e Madhe e Gjykatës në çështjen *Guiso-Gallsay v. Italisë* (kompensim i drejtë), i cituar më sipër, sipas së cilit “data e cila duhet të merret në konsideratë për përcaktimin e dëmit monetar nuk duhet të jetë ajo datë në të cilën lëshohet vendimi i Gjykatës, por ajo datë në të cilën (aplikuesit) humbën pronësinë e tokës” (*shiko § 103 të vendimit*).

23. Si pasojë, duke iu referuar aktit të vitit 1994 i cili vazhdoi të aplikohet edhe kur e drejta e aplikuesve më në fund u njoh nga vendimi i Gjykatës së Lartë më 15 qershor 2004, Qeveria deklaroi se çmimi i referencës duhej të ishte 1,600 e gjitha për metër katror (*shiko paragrafin 10 më sipër*). Ata e kundërshtuan aplikimin e çmimeve të referencës të përfshirë në hartat e vlerësimit të pronës në vitin 2008, i cili ishte miratuar si rezultat i masave të përgjithshme të përcaktuara nga Gjykata në vendimin *Driza* (*shiko paragrafin 126 të vendimit*). Megjithatë, ata shtuan se të tilla harta ishin përdorur së fundmi për të llogaritur shpërblimin e kompensimit financiar për pronarët e mëparshëm dhe ato reflektonin vlerën reale të tregut, e cila kishte pasur tregues si të interesit po ashtu edhe të inflacionit.

24. Qeveria e konsideroi si hipotetike deklaratën e aplikantëve në lidhje me konstruksionin e një ndërtese të lartë në truall dhe humbjen e përfitimeve përkatëse. Fillimisht, ata argumentuan se prona e aplikuesve i ishte shitur Ambasadës Italiane. Së dyti, konstruksioni i një ndërtese do të varej nga lëshimi i një leje ndërtimi, por gjithsesi nuk kishte garanci se ajo do të sigurohej.

25. Më tej, Qeveria mbështeti mendimin se humbja e përfitimit duhej të llogaritej në bazë të një shkalle të interesit vjetor bankar, i cili aplikohet të dhënia e kompensimit. Megjithatë, ata nuk ranë dakord si me aplikuesit ashtu edhe me përlllogaritjen e qerasë që ata do të kishin përfutur nëse do ta kishin dhënë pronën me qira.

26. Qeveria propozoi që aplikuesve t'i jepej 21,000 euro për dëmin jomonetar.

a) Parimet e aplikueshme

27. Gjykata shpjegon se një vendim në të cilin gjendet një thyerje e ligjit e vendos shtetin përgjegjës përpara një detyrimi ligjor për t'i dhënë fund thyerjes dhe për të kompensuar pasojat e tij në mënyrë të tillë që ta rimëkëmbë sa më shumë të mundet situatën drejt gjendjes së mëparshme (Iatridis v. Greqisë (kompensim i drejtë) (QGJ), nr.31107/96, § 32, ECHR 2000-XI).

28. Shtetet kontraktuese të cilat janë palët e një çështjeje, në parim janë të lira të zgjedhin mjetet me anë të të cilave ato do të procedojnë me një vendim tek i cili Gjykata ka gjetur një thyerje. Kjo pavarësi ashtu si edhe mënyra e ekzekutimit të një vendimi reflekton lirinë e zgjedhjes, bashkëngjitur me detyrimin parësor të shteteve kontraktuese nën Konventë për të garantuar liritë dhe të drejtat (neni 1). Nëse natyra e shkeljes lejon *restitutio in integrum*, përgjegjësia i kalon shtetit përkatës. Nëse, ligji kombëtar nuk lejon ose lejon pjesërisht-kompensimin për pasojat e shkaktuara nga thyerja e ligjit, neni 41 i jep të drejtën Gjykatës të mbështesë palën e dëmtuar me aq kompensim sa e gjykon ajo të arsyeshme (shiko *Brumarescu v. Rumanisë* (kompensim i drejtë) [Q GJ], nr > 28342/95, 20, ECHR 2001-I).

29. Midis çështjeve që Gjykata merr në konsideratë për kompensim janë dëmet monetare (humbjet vijnë si rezultat direkt i shkeljeve të deklaruara), dëmet jomonetare (kompensim për ankthin, shqetësimin dhe pasigurinë të shkaktuara nga shkeljet e bëra), si edhe humbjet e tjera jomonetare (shiko, midis autoriteteve të tjera, *Ernestina Zullo v. Italisë*, nr.64897/01, 25, 10 nëntor 2004). Për më tepër, nëse një ose më shumë dëme nuk llogariten siç duhet, ose dallimi midis dëmit monetar dhe jomonetar është i vështirë për t'u bërë, Gjykata mund të vendosë të bëjë një vlerësim të përgjithshëm (shiko *Comingersoll v. Portugalisë* [QGJ], nr.35382/97, 29, ECHR 2000-IV).

30. Gjykata vë re se Qeveria përgjegjëse ka ngritur dy linja kryesore për argumentim. E para ka të bëjë me truallin që duhet kompensuar dhe e dyta mbështetet mbi metodën për llogaritjen e dëmit monetar. Për pasojë Gjykata do të marrë në shqyrtim dy çështjet e mëposhtme.

b) Qëllimi i çështjes

31. Gjykata thekson se në vendimin themelor vihet re një shkelje e nenit 6 § 1 të Konventës dhe nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës në lidhje me dështimin e autoriteteve për të kompensuar aplikuesit në vend të rikthimit të pronave të tyre, duke mos zbatuar kështu vendimin e formës së prerë të gjykatës vendore në favor të aplikuesve (shiko më sipër paragrafin 3). Gjykata, gjithashtu, thekson se vendimi i formës së prerë marrë nga gjykata vendore i njeh aplikuesve të drejtën për kompensim vetëm për 1,456 m<sup>2</sup>. E drejta e tyre për kompensim për truallin me sipërfaqe 181 m<sup>2</sup>, siç ishte pranuar nga vendimet e Komisionit, nuk u mor në konsideratë.

32. Kështu, Gjykata do të kontrollojë përllogaritjen e dëmit monetar për truallin prej 1,456 m<sup>2</sup>. Në lidhje me të dhënat përkatëse në vendimin themelor, nuk është bërë asnjë ankesë për sa i përket mospagimit nga ana e autoriteteve të kompensimit ndaj aplikuesve për truallin me përmasa 181 m<sup>2</sup>.

c) Metoda e përllogaritjes

33. Gjykata vë re se në çështjen aktuale *restitutio in integrum* nuk mund të aplikohet mbi masat e marra nga gjykatat vendore. Për këtë arsye gjykatat vendore urdhëruan që aplikuesit të kompensoheshin sipas aktit të pronës. Në lidhje me këtë, Gjykata do të bëjë një rishikim të kompensimit.

34. Gjykata nuk mund të pranojë propozimin e shtetit përgjegjës për aplikimin e metodës së përllogaritjes së dëmit monetar sipas mënyrës së miratuar nga Dhoma e Madhe e Gjykatës në çështjen e *Guiso-Gallisay* (kompensim i drejtë), i cituar më sipër. Vihet re se në gjykimin e *Guiso-Gallisay* i datës 8 dhjetor 2005, dhe në çështje të tjera italiane të ngjashme në lidhje me shpronësimin e ndërtimeve, një autoritet publik kishte zënë tokën për të bërë punime publike pa plotësuar më parë procesin formal të shpronësimit. Si rezultat i kësaj, pronësia i kalonte automatikisht autoritetit publik ose pas përfundimit të punimeve ose pas një periudhe të caktuar kohe, në varësi të rrethanave. Ndryshe nga çështja *Guiso-Gallisay*, çështja aktuale nuk ka të bëjë me shpronësimin e ndërtimeve.

35. Gjykata thekson se në këtë çështje, është mospagimi i kompensimit dhe jo mënyra e paligjshme e përfuturit të tokës, si në çështjen *Guiso-Gallisay*, e cila përbën thyerjen e nenit 6 § 1 dhe nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës (shiko, *mutatis mutandis*, *Scordino (nr.1)*, cituar më sipër, § 255).

36. Në përllogaritjen e shumës së dëmit monetar, Gjykata shpjegon se, në bazë të rrethanave specifike të kontekstit shqiptar, do të ishte më mirë që të mos përdorej metoda e përllogaritjes së përshkruar në çështjen *Driza* (cituar më sipër, §137) sipas së cilës shuma e kompensimit duhet të korrespondojë më vlerën e truallit në kohën kur janë marrë vendimet e autoriteteve vendore. Gjykata

vëren se në atë kohë hartat e vlerësimit të tokave nuk ekzistonin. Shteti përgjegjës duhej t'i miratonte me urgjencë të tillë harta, me qëllimin e vetëm për të përlllogaritur shumën e kompensimit financiar dhe për të shmangur ndonjë spekulim të përmendur nga Gjykata sipas nenit 46 të Konventës (shiko *Driza*, cituar më sipër, § 126).

37. Gjykata vë re me interes se autoritetet kanë miratuar hartat e vlerësimit të pronave për të gjithë territorin e Shqipërisë. Çmimi i referencës, ashtu siç ishte theksuar nga Gjykata, reflekton vlerën reale të tregut dhe përmbante tregues si të interesit ashtu edhe të inflacionit në kohën e miratimit të hartave. Kështu, Gjykata do t'i mbështesë përlllogaritjet e saj për dëmin monetar mbi hartat e vlerësimit të pronave të miratuara sipas rajonit të Tiranës në vitin 2008.

38. Gjykata e hedh poshtë kërkesën e aplikuesve për kompensim për dëmin e shkaktuar nga pamundësia për përdorim dhe zotërim të truallit. Ajo vë re se vendimet e gjykatave vendore ishin të qarta për sa i përket kompensimit të aplikuesve në vend të rikthimit të pronës, kështu që aplikuesit nuk mund t'i interpretojnë ato vendime si një mundësi e mëvonshme që ata të mund ta japin me qira tokën apo të ndërtojnë një godinë në të.

39. Duke marrë parasysh këto faktorë si edhe duke qenë racional në vendimmarrje, Gjykata e konsideron të arsyeshme t'i akordojë aplikuesve 1,900,000 euro për dëmin monetar dhe jomonetar, plus edhe çdo taksë tjetër, e cila mund t'i ngarkohet kësaj shume.

#### B. Kostot dhe shpenzimet

40. Aplikuesit deklaruan një shumë të përafërt prej 18,000 eurosh për kostot dhe shpenzimet e bëra gjatë procedurave vendore dhe atyre në Strasburg. Megjithatë, ata nuk mundën të paraqisnin dokumente mbështetëse.

41. Qeveria pranoi se shumata e deklaruara nuk kishin baza për t'u vërtetuar.

42. Sipas ligjeve për çështjet e Gjykatës, një aplikues rimbursohet për kostot dhe shpenzimet e tij, për aq kohë sa vërtetohet se ato janë bërë në të vërtetë dhe janë bërë sipas nevojave dhe situatës (shiko *Gjyli v. Shqipërisë*, nr.32907/07, § 72, 29 shtator 2009). Së fundmi, rregulli 60 §§ 2 dhe 3 të rregullave të Gjykatës përcakton se aplikuesit duhet të bashkëngjisin me kërkesat e tyre për kompensim "çdo dokument tjetër mbështetës", në të kundërt Gjykata "mund t'i kundërshtojë kërkesat në tërësi ose pjesërisht".

43. Në lidhje me çështjen konkrete, Gjykata nuk akordon ndonjë shumë për kostot apo shpenzimet, duke qenë se aplikuesit nuk paraqitën ndonjë dokument, si për shembull, fatura të artikujve apo *invoice*.

#### C. Interesi i papaguar

44. Gjykata e shikon si të arsyeshme që interesi i papaguar të bazohet në shkallën marginale të huas sipas Bankës Qendrore Europiane, duke iu shtuar tre për qind.

### PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË UNANIMITET

#### 1. Vendos:

a) se shteti përgjegjës duhet t'i paguajë aplikuesit së bashku, brenda tre muajve nga data në të cilin vendimi bëhet i formës së prerë në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, 1,900,000 euro (një milion e nëntë qind mijë euro) bazuar në dëmin monetar, plus edhe çdo taksë që mund të jetë e tatueshme, duke i konvertuar në sistemin monetar vendas të shtetit përkatës sipas normave që aplikohen në datën e bërjes së pagesës;

b) që prej përfundimit të tre muajve të sipër përmendur deri në momentin e pagesës interesi do të paguhet sipas shumës së mësipërme me një vlerë të njëjtë me vlerën marginale të huas së Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre për qind;

#### 2. Heq nga përgjegjësia e vet kërkesën e aplikuesit për kompensim.

E mbajtur në anglisht dhe në formë të shkruar, më 7 dhjetor 2010, në bazë të rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të rregullave të Gjykatës.

REGJISTRAR  
Lawrence Early

PRESIDENT  
Nicolas Bratza

**UDHËZIM**  
**Nr.17, datë 5.11.2010**

**PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PROFILEVE E MOSTRAVE PËR SIPËRFAQEN E  
TOKËS QË ANALIZOHET DHE VLERËS SË ANALIZAVE TË TOKËS**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.655, datë 28.7.2010 “Për rregullat dhe procedurat e ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës”, kreu III, pika 3,

**UDHËZOJ:**

1. Numri i profileve për vlerësimin e treguesve pedagogjik të jetë:
  - a) në toka fushore, me pjerrësi 1-5%, hapet një profil për sipërfaqe deri në 10 ha;
  - b) në toka me pjerrësi mbi 5%, hapet një profil për sipërfaqe deri në 5 ha.Brenda hapësirës për të cilën kryhen analizat, hapen deri dy profile ndihmëse, në raste kur kërkohet përcaktimi i kufirit të ndryshimeve midis tipave, nëntipave dhe llojet e tokave.
2. Numri i mostrave përfaqësuese për vlerësimin e treguesve agrokimik të jetë:
  - a) në toka fushore, me pjerrësi 1-5%, merret një mostër përfaqësuese për sipërfaqe deri në 8 ha;
  - b) në toka fushore, me pjerrësi 1-5%, me sipërfaqe heterogjene, merret një mostër mesatare për sipërfaqe deri në 4 ha;
  - c) në toka të pjerrëta merret një mostër përfaqësuese për sipërfaqe deri në 3 ha.2/1. Për krijimin e mostrës përfaqësuese, sasia e mostrave ndihmëse të jetë si vijon:
  - a) për sipërfaqe më të vogël se 2 ha, merren jo më pak se 15 mostra ndihmëse;
  - b) për sipërfaqe më të madhe se 2 ha, merren jo më pak se 20 mostra ndihmëse.
3. Vlera e analizave të tokës të jetë si vijon:
  - a) vlera për hapje profile, marrje mostre dhe përpunim, ambalazhim, etiketim të saj, për llogaritjet e barabartë me pagesën ditore + sigurimet shoqërore të një punëtori bujqësie, në shumën 1360 lekë;
  - b) shpenzimet e analizave të mostrave për treguesit pedagogjik e agronomik, të jenë sipas përcaktimit të udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministrit të Financave, nr.8, datë 8.5.2007 “Mbi tarifat e të ardhurave dytësore, të aplikueshme nga institucionet vartëse të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit”;
  - c) për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë.Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT  
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT**  
**Genc Ruli**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin e datës 18.5.2010, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasës Lumturi Bami, e bija e Bajramit dhe Liries, e datëlindjes 11.6.1983, lindur në Tiranë dhe banuese në fshatin Tapizë Krujë, dhe caktimin si kujdestare të saj kërkuesen Anila Bami, banuese në fshatin Tapizë Krujë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin e datës 28.5.2010, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Xhaferr Nuzi, i datëlindjes 2.8.1958 dhe caktimin si kujdestare të tij kërkuesen, Kristina Nuzi.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin e datës 16.6.2010, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Lindita Alushi, e datëlindjes 14.2.1974 dhe caktimin si kujdestare të saj kërkuesen, nënën e saj, Fitnete Alushi.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin e datës 23.6.2010, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Shpresa Balliu, e datëlindjes 19.8.1962 dhe caktimin si kujdestare të saj kërkuesen, Dhurata Balliu.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin e datës 7.7.2010, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Albert Caca, i datëlindjes 3.7.1983 dhe caktimin si kujdestare nënën e tij, kërkuesen, Servete Murati.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin e datës 15.7.2010, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Anisa Tabaku, e datëlindjes 3.4.1992 dhe caktimin si kujdestare të saj kërkuesen, Liliana Tabaku.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin e datës 21.7.2010, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Sanije Qoshja, lindur në vitin 1951 dhe caktimin si kujdestar të saj kërkuesin, Ismet Qoshja.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin e datës 26.7.2010, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Denisa Çeço, e datëlindjes 29.9.1988 dhe caktimin si kujdestare të saj kërkuesen, Geralda Çeço.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin e datës 29.7.2010, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Mentor Vathi, i datëlindjes 16.5.1980 dhe caktimin si kujdestare të tij kërkuesen, Valbona Vathi, e datëlindjes 28.4.1975.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë me vendimin e datës 20.9.2010 vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Mustafa Cela i datëlindjes 4.3.1945 dhe caktimin si kujdestare të tij kërkuesen Liljana Cela e datëlindjes 29.12.1980.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin e datës 2.11.2010, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Myrteza Dema, i datëlindjes 28.6.1968 dhe caktimin si kujdestare të tij kërkuesen, File Dema, e datëlindjes 25.8.1969.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin e datës 10.11.2010, vendosi kufizimin e zotësisë juridike për të vepruar për shtetasen Flutura Kasem Bami, e datëlindjes 23.2.1958 dhe caktimin si kujdestare ligjore të saj kërkuesen, Miranda Qemal Bami.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin e datës 1.12.2010, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Flutura Farruku, e datëlindjes 25.9.1966, e bija e Islamit dhe Meremes dhe caktimin si kujdestare të saj kërkuesen, Drita Farruku, e datëlindjes 6.9.1985.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin e datës 2.12.2010, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Lumturi Kurti, e datëlindjes 17.11.1971, e bija e Kurtit dhe Razijes dhe caktimin si kujdestare të saj kërkuesen, Shqipe Kurti.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin e datës 22.12.2010, vendosi heqjen e zotësisë juridike për të vepruar të shtetasit Bledar Metalla, i datëlindjes 16.9.1992, i biri i Myfitit dhe Luljetës dhe caktimin si kujdestare, nënën e tij, Luljeta Metalla, e datëlindjes 5.2.1968 e bija e Zojes.

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**  
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

## BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 8.8.2011  
Doli nga shtypi më 10.8.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2011

Çmimi 40 lekë